



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br.	92/21
Nr. i Sq. / Br. st	- 29 -
Datei / Datum	29. 04. 2021
VUČITRN : VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCES VERBAL

NGA MBLEDHJA E -III- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 25 MARS 2021

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gérxhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Fitim Halili, Ismet Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Melihate Basholli-Latif, Suzana Syla, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, nënkyetari i komunës z.Afrim Namani, drejtorët e drejtive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 35 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Në fillim të mbledhjes Agim Krasniqi dhe betimin para kuvendit, duke u bërë anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me të drejtë të plota.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e tij lidhur me gjendjen e sigurisë në fshatin Stanoc i Epërm, ku atje ka forca të shumta të policës dhe fshati është pothuajse tërësisht i rrethuar. Ai pyeti kryetarin e komunës se çfarë është duke ndodhur në fshatin Stanoc i Epërm, pse e sjellët gjendjen deri këtu, atje ka filluar tërheqja e nxënësve nga shkolla nga prindërit e tyre.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi se në fshatin Stanoc i Epërm nuk ka shtet rrithim siç po pretendohet, kjo është gënjeshtë. Pastaj në këtë fshat po zbatohet një vendim i komunës, për ti hapur gjashtëdhjetë (60) vende pune për gratë e fshatit Stanoc i Epërm dhe rrëthinës, dhe si ai nuk mbanë përgjegjësi për përcarje të banorëve lokal, por përgjegjësi duhet të bartin ata që kanë nënshkruar peticione fallco, dhe kësijoj kanë tentuar që me këto forma të pengojnë hapjen e 60 vendeve të reja të punës. Fëmijët e fshatit Stanoc i Epërm nuk kanë arsyë ti lëshojnë bankat shkollore, për teke të dikujt, pasi ata e kanë objektin e ri shkollor të nivelit modern, objekt i cili është ndërtuar me fondet e komunës, dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet që të shërbej edhe për çerdhe, për kënde lexime dhe për muze.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se është për keqardhje fjalori i përdorur nga ana e kryetarit të komunës, dhe përsërit se në fshatin Stanoc i Epërm, ka forca të njësisë speciale që po ndikojnë në traumatizmin e nxënësve të këtij fshati pasi që shkolla është e rrethuar nga policia.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-pasi uroj emërimin e drejtoreve të rinj në administratën komunale, ceku se kjo mbledhje e kuvendit është jo e këndshme, pasi që reagimi protestues i banorëve të fshatit Stanoc i Epërm po vazhdon dhe shtoi se përgjegjësia është e jona që mos të lejojmë konfrontimin e qytetarëve mes veti. Andaj ftoj të gjitha subjektet politike që me gjuhën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të gjejmë një zgjidhje meritore për të shmangur ndonjë konflikt eventual dhe pasoja të mundshme. Ai apeloi tek të gjitha palët që përbahen nga gjuha fyeze dhe ofenduese dhe ti jepet mundësi zgjidhjes të qëndrueshme që është e favorshme për të gjithë. Ai ceku se peticioni është një e drejt qytetare e demokratike që shërben si instrument për realizimin e të drejtave qytetare dhe i tillë duhet të shqyrtohet dhe të vendoset në meritum duke shmangur konfliktet dhe pasojat e mundshme por edhe duke i dhënë mundësi investimeve të cilat janë shumë të nevojshme.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-të nderuar anëtarë të Kuvendit, të dashur qytetar para se të filloj rendi i ditës, desha të shpreh një shqetësim sa i përket një vendimi që ne e kemi marr në muajin dhjetor në seancë të jashtëzakonshme për përkrahjen financiare për qytetaret e prekur me Covid. Ne atë vendim është potencuar se do të ketë efekt retroaktiv nga viti 2020 dhe do filloj të prodhoj efekt juridik nga 5 janari 2021 duke u pranuar aplikacionet nga qytetaret Përveç kësaj, e rëndësishmja është që për zbatimin e këtij vendimi është obliguar Drejtoria për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale dhe ajo e financave. Ani pse flitej që është duke u përgatitur nga drejtoria një formë e aplikacionit online me kriterë, kur u ftuam ne si komision për here të pare në mbledhje 10 dite me herët e që ish dashur në fakt që atë mbledhje ta kemi të fundit sa i preket shqyrtimëve të aplikacioneve, neve na u krijua një mjegulli, duke mos pasur mundësi ta takojmë as drejtorin e Shëndetësisë i cili as nuk ekzistonte ato dite, e askënd nga ajo drejtori që kishe përgatitur diçka për ekzekutimin e këtij vendimi. Komisioni i zgjedhur nga kuvendi për këtë çështje, nuk është kompetent as për caktim kriteresh, as për përgatitje të aplikacioni por decidivisht për vlerësim e shqyrtim aplikacionesh. Në kohë pandemie, Komuna mbeti pa drejtor shëndetësie për një periudhë e këto premtimet për përkrahje financiare si duket janë bërë veç për të qenë në titujt e portaleve për një ditë, ama serioziteti për të shtyrë përpara këtë vendim ka qene i barabarte me zero. Si anëtare e këtij komisioni nga radhët e Lëvizjes, kërkoj publikisht falje para qytetarëve që janë duke pritur të aplikojnë, dhe në anën tjetër nga e njëjta pozite kërkoj nga ekzekutivi që ta marrin seriozisht zbatimin e këtij vendimi deri në pikën ku ne si komision ti kemi aplikacionet në dorë për ti vlerësuar.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-tha se çështja e fabrikës në shkollën e fshatit Stanoc i Epërm, është vërtetë brengosëse, kjo përfaktin se kemi pozicionim të dy taborëve dhe asnjëra nuk ja pranon tjetrës, kjo ka ngjallë pezëm dhe mund të ketë konflikte, andaj kërkoj të gjendet një zgjidhje.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-duke ju referuar diskutimit të znj. Gresa Muli, vlerësoi dhe sqaroi se nuk duhet krijuar amulli dhe se duhet informuar drejt qytetarët, pasi zbatimi i vendimit për subvencione për të prekurit me covid-19, nuk ka mundur të bëhet pa u bërë alokimi i mjeteve nga niveli qendror. Një gjë e tillë do të bëhet sot pas alokimi është bërë dhe sot do të merret vendimi për ndarjen e subvacioneve nga ana e kuvendit të komunës. Mirëpo komisioni është dashur të aprovoj një formë të aplikacionit dhe ti shqyrtoj aplikacionet duke i vendosur kriteret, a pas takimit do duhej të bënte një njoftim zyrtar për sa i takon alokimit të buxhetit dhe fillimit të ekzekutimit të vendimit pasi kjo ka qenë detyrë e këtij komisioni. Pastaj komisioni do duhej që ta

bënte kalkulimin e kostos financiare të këtij vendimi duke konstatuar se mjetet e ndara a do të mjaftojnë për ti financuar nevojat konform aplikacioneve të qytetarëve, dhe nëse jo të dilet me një propozim në kuvend se si të veprohet, kjo ka qenë detyrim qytetar i këtij komisioni.

Gresa Muli, anëtar i kuvendit-tha se kryetari i komunës e ka princip me i devijuar diskutimet e anëtarëve të kuvendit, dhe sqaroi se ajo më lartë kishte deklaruar, se nuk është ndërmarr as edhe një veprim për zbatimin e vendimit për subvencionet për të prekurit me covid-19, edhe pse në vendim mjaft qartë është definuar se kush e zbaton vendimi dhe atë e zbaton: Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Shëndetësisë. Ajo vlerësoi se nuk është zyrtare e IT që të hartoj aplikacione online, dhe se punët e ekzekutivit komunal nuk mund ti kryej komisioni i cili ka për detyrë vetëm ti vlerësoj aplikacionet e qytetarëve.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se kishte me qenë mirë që si pikë e rendit të ditës të futet, ndryshimi plotësimi i vendimit për themelimin e këtij komisioni të vlerësimit të aplikacioneve, pasi që ai si anëtar i kuvendit ka dhënë dorëheqje.

Afrim Namani, nënkyrytarë i komunës-sqaroi se deri kah fundi i muajit janar, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë ka qenë në pozitën e tij, më pastaj është shkarkuar, por vendimi i kuvendit për ndihen e dhënë për të prekurit me covid-19, ka filluar të prodhoj efekt juridik nga data 5 janar 2021 dhe deri në këtë kohë nuk është ndërmarr asnjë veprim nga ish drejtori, për këtë nuk i di arsyet. Si ushtrues detyre në Drejtoren e Shëndetësisë, puna e para që ka ndërmarr ka thirrur këtë komision dhe iu ka caktuar një takim, ku edhe vet kishte marr pjesë, ashtu që pa kurrfarë imponimi ish caktuar rendi i ditës dhe ishte zgjedhur edhe kryesuesi i komisionit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se deri sa po flasim protesta e banorëve në fshatin Stanoc i Epërm është duke vazhduar, për faktin se banoret nuk pranojnë që shkolla fillore “Migjeni” të shfrytëzohet si fabrikë për këtë kemi kundërshtim të madh dhe të ashpër të banorëve. Në këto momente në Stanoc të Epërm, ka forca policore në numër të madh, dhe gjendje ta krijon përshtypjen e kohës së ish regjimit që ka sunduar Kosovën, prandaj një gjë e tillë si kryetari i Këshillit të Fshatit dhe si anëtar i kuvendit është e papranueshme, njoftoi se tash e tutej do të tërhiqen edhe nxënësit nga objekti shkollor. Ai kërkoi që ky material i futur në rend të ditës të plotësohet edhe me kontratën e lidhur mes kompanisë dhe kryetarit të komunës si dhe lista poseduese që dëshmon pronësinë e pronës ku gjendet objekti shkollor, kjo për faktin se ajo tokë është në pronësi të Kooperativës Bujqësore dhe menaxhohet nga AKP-ja.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi se marrëveshja e lidhur mes komunës dhe Kompanisë “Vitex” është e publikuar në faqen zyrtare të komunës, andaj Sekretaria e Kuvendit, mundet që ta publikoj linkun ashtu që të kenë qasje të gjithë anëtaret e kuvendit.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-kërkoj nga të gjithë anëtaret e kuvendit, kryetari e ekzekutivi i komunës që ti ulin gjakrat, të debatojnë shtruar e me dialog duke i thirrur arsyje, sepse të gjitha problemet mund të zgjidhen me forcën e dialogut e mirëbesimit. Ai pasi uroj emërimin e drejtoreve të rinj, kërkoi që ata të prezantohen me emër dhe mbiemër ashtu që të jenë të ditur për publikun dhe të rritet transparenca.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-prezantoj drejtoret e rinj të emëruar, ku njoftoj se: Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë është emëruar Dr. Bujar Pllana, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Shkelzen Xhaferi (ekonomist), Enis Maxhuni-(ekonomist) është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtje dhe Shpëtim, Kujtim Pllana (ekonomist), Drejtor i DEBPZHR-së, Edona Gashi, është emëruar Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Arta Ismajli, është emëruar Drejtoreshë e DKRS-së nga shoqëria civile, Rakbetet Krasniqi-Melenica është emëruar Drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit dhe Afrim Namani është emëruar nënkyrytar i komunës.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-prezantoj para kuvendit rendin e ditës, duke inkorporuar edhe pikat shtesë të dërguara në pikën në të ndryshme.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se shumë prona por edhe shumë objekte të rëndësisë vitale komunale siç janë edhe shkollat gjendjen në pronësi të dikujt tjetër të AKP-së apo privatëve, krejt kjo si rezultat i mungesës së elaborateve kadastrale, por komuna ka hartuar listën e këtyre pronave dhe të gjitha do ti procedoj në gjykatë për ti zgjidhur këto konteste.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se prona që pretendohet ti jepet në shfrytëzim Kompanisë “VITEX” është pronë e Kooperativës Bujqësore dhe menaxhohet në nga AKP-ja, kjo pronë më herët iu është marrë një personi privat Rexhep Haradinajt në vitet e 70-dhjeta, prandaj është tokë kontestuese dhe për të cilën do të ketë edhe padi gjyqësore.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-pasi uroj drejtoret e rinj të emëruar, shprehu mëdyshjet e tij lidhur me realizimin e objektivave që i kanë para vetes këta drejtor, për shkak të kohezivitetit që kanë mes vetit. Skepsa e tij qëndron tek ajo sepse tek Drejtoria e Shërbimeve Publike kemi jo produktivitet e si rezultat del se kemi nga tri vrima-gropa rrugore për kokë banori. Emërimi i drejtoreshës së Kulturës, nuk është nga shoqëria civile por ajo vjen nga LDK-ja pasi nga kjo e fundit është emëruar. Në këtë dikaster komunal me rëndësi, nuk ka pasur kurrfarë rezultatesh të deri tanishme dhe kjo drejtori ka qenë gati inekzistente. Ajo çka është e rëndësishme është debati i hapur për klubin e futbollit “Vushtrria” për të cilin kërkoj që kjo të jetë pikë e rendit të ditës. Ai vlerëson dhe konstaton se në periudhën e qeverisjes të Partisë Demokratike është investuar shumë në fushën e kulturës dhe të sportit. Por ajo se çfarë është e dhimbshme është shkatërrimi i klubit të futbollit nga disa persona jo kredibil që e kanë katandisur këtë klub. Ai kërko nga drejtoresha e re që të angazhohet fuqishëm në nxjerrjen nga kjo gjendje e keq që e ka mbërthyer klubin e futbollit.

Arta Ismajli, drejtoreshë e DKRS-së-tha se prej së është emëruar drejtoreshë në Drejtorinë e Kulturës, klub i futbollit “Vushtrria” është problematika e parë që ka hasur, dhe është mirë që kjo temë do të jetë objekt shqyrtimi në këtë mbledhje të kuvendit. Ajo sqaroi se ndikimi politikë i qeverisë së komunës mbi një OJQ siç është klub i është tejet i vogël apo nuk ekziston fare, për më tepër kjo bien ndesh me ligjin pozitiv të Kosovës. Ajo u zotua para kuvendit se në bashkëpunim me kryetarin e komunës do të bëjnë përpjekje për gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme për nxjerrjen e klubit nga kjo gjendje e rënd. Lidhur me menaxhimin e fushës sportive, ceku se ajo i është dhënë në shfrytëzim me një akt nga ana e drejtorit i cili ka qenë nga radhët e PDK-së.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se me keqardhje deklaron por drejtoresha e Kulturës, nuk e ka guximin për të negociuar dhe për ti shtyrë proceset përpara.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pasi uroj drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, për pozitën udhëheqëse që ka marrë., konsideron dhe vlerëson se gjithherë do të interesohet për çështje që janë me interes për qytetarët e komunës së Vushtrrisë. Ajo që politika nuk ka autorizime të ndërhyj në sport është e vërtet, por që nga drejtoresha e kaluar dhe kryetari i komunës ka pasur tentativa, sepse në fillim u tha se klub i futbollit është privatizuar por që më vonë doli se nuk është e vërtet. Sa i përket formës që duhet gjetur është mirë dhe propozoi që të hartohej një rregullore për menaxhimin e stadiumit të futbollit.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-pasi i uroj sukses drejtoreve të rinj të emëruar, ceku se realizimi i konceptit të barazisë gjinore nuk duhet bazuar vetëm në kuota por në realizim praktik të saj, për këtë i vjen shumë mirë që në qeveri ka tri gra anëtare të qeverisë komunale. Tutej ajo kërkoj që në rend të ditës të futet kërkesa e Fitim-Fazli-Pllanës i cili merret me shitjen ambulantive të pemëve dhe perimeve në fshatin Nedakoc, për këtë ajo kërkoj që këtij ti gjendet një lokacion i përshtatshëm që mundëson zhvillimin e veprimtarisë së tij.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale janë të qarta dhe striket ku nuk lejohen ndikime dhe caktim të titullarëve apriori.

Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 34 vota “për” 1 votë “abstenum” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 25 shkurt 2021;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja solemne i datës 05 mars 2021;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2020;
4. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për rrënimin e objektit të ish Gjykatës së Komunës;
5. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sheshit të Pavarësisë në Vushtrri;
6. Shqyrtimi i Propozim–vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2021;
8. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2020/2021;
9. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës për Punë Sociale;
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Ndërmarrjes regionale “Uniteti”;
11. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.01-35/21 i datës 25.02.2021, për shtyrjen e afatit të pagesës së këstir për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë;
12. Shqyrtimi i peticionit i parashtruar nga banorët e lagjes “Kalaja”.
13. Shqyrtimi i peticionit të parashtruar nga banorët e fshatit Stanoc i Epërm, lidhur me kundërshtimin e marrëveshjes në mes kryetarit të komunës dhe fabrikës së tekstitit “VITEX” për shfrytëzimin e objektit të vjetër të Shkollës Fillore “Migjeni”, për qëllime biznesore;
14. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;
15. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për specifikimin e projekteve kapitale të Komunës së Vushtrrisë;
16. Diskutimi dhe shqyrtimi i gjendje së Klubit të Futbollit “Vushtrria”;
17. Shqyrtimi i kërkesës së Fitim-Fazli-Pllanës për gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarisë së tij biznesore;
18. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 25 shkurt 2021;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25 shkurt 2021.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja solemne i datës 05 mars 2021;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja solemne e kuvendit, e datës 5 mars 2021.

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2020;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se nëse analizojmë buxhetin tek drejtoritë komunale, në saje të raporti del se drejtoritë e udhëhequra nga LVV-ja kanë performancë më të dobët, krahasuar me ato të udhëhequra nga partneri tjetër LDK-ja. Kjo sidomos ndikon keq jo vetëm në realizimin e buxheti por edhe në zhvillimin e gjithmbarshëm të komunës. Shprehur në terma tjerë kemi suficit apo buxhet të pashfrytëzuar në disa dikastere komunale që po e dëmtojnë komunën dhe qytetarin e Vushtrrisë shifrat shkojnë mbi 3,000.000 € që kjo qeveri komunale nuk ka arritur ti futë në funksion në kategorinë e investimeve kapitale. Humbja reale është se këto mjete nuk kanë dalë në treg dhe kjo e ka varfëruar qytetin dhe qytetarin tanë. Ai e kupton faktin se viti i kaluar ka qenë vit pandemikë dhe ka pasur vështirësi në realizimin e projekteve por si duket nuk ka pasur përpjekje maksimale për realizmin e këtyre projekteve të parapara në buxhetin e komunës. Ajo që është e nevojshme dhe që duhet adresuar është mungesa e kapaciteteve profesionale, në administratën komunale dhe këtu duhet intervenuar shpejt nëse dëshirojmë të kemi prosperitet në komunë tonë, zhvillimet teknike e teknologjike sa do që kanë shkuan larg, faktori njeri mbetet tepër i veçantë e me një rëndësi kruciale për zhvillimet bashkëkohore dhe jo vetëm. Pastaj shtoi se zgjatja e stërvizgjatja e zhvillimit të projekteve vërtet po ndikon keq edhe në ndërtimin e rrugëve, duke mos u respektuar plani dinamik i realizimit të projektit, për këtë duhet të angazhohen më tepër mbikëqyrësit e kontratave, në të kundërtën duhet të rishikohen këto kontrata.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së-sa i përket realizmit të buxhetit nëpër drejtori, qeveria ka punuar si ekip jo ndaras. Pastaj shtoi se rreth 1,700.000 € do të barten, ndërsa pjesa prej 1,300.000 € do të shkoj në suficit, ndërsa realizimi i buxhetit është bërë në masën 86 %, dhe kjo kur llogariten kushtet pandemike, i bie se kemi një shifër të mirë të realizmit të buxhetit për vitin 2020.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se vërtet viti që lëmë pas ka qenë vite i rënd në ballafaqim me pandeminë covid-19, megjithatë realizmi i buxheti është bërë në vlerën 86 % që nuk është një shifër e ulët, ndërsa 71% janë realizuar investimet kapitale, këto shifra janë mbresëlënëse për faktin se 3 muajit e vitit të kaluar ka qenë gjithçka e mbyllur dhe kjo ka ndikuar në pezullimin e aktivitetave kontraktuese në realizmin e projekteve. Por edhe përkundër ballafaqimit me pandeminë komuna ka arritur ti mbështes finansiarisht 820 fëmijë të porsalindur me nga 120 €, mandej përkrahja e bizneseve për tu mos u shuar dhe janë përkrahur 513 biznese me vendim të kuvendit me 300 deri 1500 €, shuma totale e mjeteve të shpërndara tek biznesi Vushtrrias është 250,000.00 €. Janë kompensuar dëmet nga vërshimet që kanë ndodhur me 17 dhe 18 gusht 2020 që kanë ndodhur në rajonin e Dumnicave, ndërsa kompensimi i dëmeve natyrore të fund vtit janë në proces të realizmit me një fond prej 162.000.00 € që janë ndarë nga Qeveria e Kosovës, ky kompensim do të bëhet në masën deri 30 % për ekonomit familjare që janë bërë nga vërshimet. Pastaj në tri vitet e fundit janë realizuar obligimet që dalin nga kontrata kolektive për stafin shëndetësor, po ashtu është përbushur kontrata kolektive edhe në lëmin e arsimit, me çka kemi pasur dëme financiare në kategorinë e investimeve kapitale për shkak të këtyre obligimeve. Janë ndihmuar 3000 familje, duke iu ofruar shërbime shëndetësore në shtëpi për të sëmurët rënd që janë prekur nga covid-19, për nënët lehon, për peronat e palëvizshëm dhe po ashtu po realizohen edhe investime kapitale si: çerdhja e re, palestra sportive, shkolla e muzikës, ndërtesa e re e QKMF-së

e shumë projekte tjera të cilat e kanë marr rrugën e kompletimit dhe presim që deri në verën e këtij vite këto projekte të përfundojnë. Në fund tha se ka qenë një vit i rënd në pandemikë por në nivel Republike jemi të kënaqur me realizimin e buxhetit dhe përfundimin e projekteve kapitale.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” aprovoj raportin për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2020.

4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rrënimin e objektit të ish Gjykatës së Komunës;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kjo pikë e rendit të ditës i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore sipas legjisacionit në fuqi dhe në pikën 3 të këtij vendimi është saktësuar ashtu si edhe është kërkuar shfuqizimi i vendimit të mëhershëm për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim i datës 31.01.2019. Andaj njoftoi se grupi kuvendar i PDK-së do ta përkrah këtë propozim-vendim për ndërtimin e shesheve të reja dhe krijimin e hapësirave publike në të mirë të qytetit dhe qytetarëve.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se është i çuditshëm qëndrimi i shefit të grupit kuvendar të PDK-së si ato ndërrohen brenda një kohe të shkurtër, tutje shtoi se diskutimet e saj e në emër të grupit kuvendar të Lëvizjes Vetëvendosje për këtë pike janë afruar tek dyshifrori. Secilën herë që ky vendim po na vjen në tavolinë, po shihet qarte që pas gjithë këtij insistimi përrënimin e këtij objekti qëndron diçka shumë më e madhe se vullneti i mirë për të ju krijuar qytetarëve hapësira publike. Po e ripotencioi prapë se në Kuvend e kemi vlerësuar para se ta votojmë vendimin aktual për këtë pronë, e ne nuk jemi këtu makinë përgritje duarsh, sa here qe ju keni matematikat tuaja. Insistojmë që për këtë objekt të zbatohen procedurat e vendimit aktual, të u jepet mundësia qytetarëve të aplikojnë. Ka shumë gjera të cilat mund të bëhen në atë objekt, dhe rrënimi i saj do të duhej të ishte opzioni i fundit, sepse edhe sikur të mos kishte asnjë të interesuar për ta marr atë pronë, Vushtrria ka nevojë për shumë gjëra. Zyre për organizatat joqeveritare që kane kushte jashtëzakonisht të pa përshtatshme aty ku qëndrojnë aktualisht, qëndrim ditor për të mos huarit, qendër rekreative përfëmijë, e tjera. Kryetar tregimet përvullnetin e mire për krijuar hapësirash publike nuk pijn ujë. Nuk mundesh me qene i thtar i hapësirave publike kur veç një lagje më poshtë mu përballë çerdhes publike u ke pamundësuar nënave të lëvizin me karroce të fëmijëve, njerëzve me nevoja të veçanta e besa edhe këmbësoreve lëvizjen, për çka? Për ti jap leje lokaleve që ta shfrytëzojnë trotuarin përzgjerim terash. Edhe njëherë, i ftoj koleget e mi asamblistë që të janë parimor e të qëndrojnë prapa dorës së ngritur për të njëjtin objekt në mbledhjen e muajit janar të vitit 2019 sepse kur e kemi marr atë vendim kemi qenë mjaftueshëm të vëmendshëm.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se parafolësja e tij nuk është vetvetja e saj, ajo nuk ka qëndrim, dhe diskutimin të cilin e lexoj më herët nuk është i saj atë e ka të shkruar nga dikush tjetër dhe kjo një mend e bënë atë makinë votuese. Pastaj shtoi se nuk e di që parafolësja a e ka lexuar raportin e vlerësimit të këtij objekti kiu thuhet se ai nuk e ka qëndrueshmërinë e dëshirueshme. Pastaj ai objekt ka filluar të dëmtohet më të madhe, për më keq vendndodhja e tij është buzë rrugës në trotuar dhe se i vetmi vendimi i drejt është rrënimi i atij objekti.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-arsyetoj se nga askush nuk merr mesazhe, dhe nuk ndikohet nga askush për qëndrimet politike që i prezanton në kuvendin e komunës. Ajo diskutimet i shënon dhe i mban në telefon të mençur, në njëren nga aplikacionet, sepse në kushtet bashkëkohore jetesa është digitalizuar sidomos të rinjtë e shfrytëzojnë telefonin. Lidhur me raportin e vlerësimit të objektit, citoj se pas konsultimeve që ka pasur me profesionist të fushës del se ky objekt është i stilit ndërtues masiv që ka qëndrueshmëri deri në 600 vite.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit-tha se nuk është ndonjë çudi bashkëpunimi i LDK-së me PDK-në. Tëtje shtoi se konsideron se objekti i ish-gjykatës komunale nuk bënë dhe nuk duhet të rrënohet, pa kaluar nëpër procedurat për të cilat ky kuvend ka marrë vendim para më shumë se një vit. Gatishmëria e PDK-së për ta votuar pro këtë propozim-vendim për rrënimin e këtij objekti e shpërfaqë hapur koalicion e fshehtë që kanë në mes veti PDK dhe LDK, por që për shkak të opinionit publik nuk po kanë guxim ta formalizojnë edhe si marrëveshje edhe si ndarje të përgjegjësive në ekzekutivin e komunës. Meqenëse nuk po e formalizojnë këtë koalicion kjo tregon se këto dy subjektet politike janë në panik, dhe bashkëpunimi dhe bashkimi i tyre nuk është as rastësi e as aksident, pra bashkimi i tyre është edhe konsistencë edhe kontinuitet. Pra të nderuar qytetarë ky bashkim i LDK-së dhe PDK-së, në mungesë të ideve dhe vizionit për zhvillim e ndërtim, kanë marrë përsipër që vetëm të rrënojnë çdo gjë në këtë qytet. Andaj këto dy subjekte politike, edhe në dekadën e tretë të këtij shekulli kanë zgjedhur që të rrënojnë herë veç e veç e herë të dyja së bashku çdo objekt çdo fabrikë e tash së fundi edhe objektet shkollore. Këta janë bashkë kudo kur ka interesa të ngushta e përfitime personale. Sheshi i "Pavarësisë" që po përfillet të ndërtohet në këtë pjesë të qytetit nuk është qëllim në vetvete, pra sheshi nuk është qëllimi parësor qëllimi është ajo çka fshihet prapa këtij sheshi, sepse nuk mund të ketë shesh serioz në një hapësirë kaq të vogël, qëllimi i rrënimit të këtij objekti është lirim i hapësirës për ndërtimin e objekteve banesore për njerëz të afërt me pushtetin në këtë pjesë, krejt kjo se LDK e PDK sa herë janë vënë në rrezik nga humbja e pushtetit edhe e kanë ruajtur e edhe e kanë mirëmbajt njëra tjetrën dhe kjo është fakt njëzet vjeçar. Këto parti udhëhiqen nga tri parime kryesore pushteti, privilegjet dhe parat, sepse fika e humbjes së pushtetit e bashkë me të edhe parat i bënë këta që rigrupohen e me mirëmbajt njëra tjetrën. Në situata të rrezikshme e kemi gjithë të ditur se "bashkohen edhe kafshët" sepse atëherë kur ka rrezik nga tërmëtet, vërvshimet dhe zjarret as kafshët nuk e sulmojnë njëra tjetrën. Nëse dikush nga kjo ndihet i ofenduar ai kërkon falje për krahasimet ilustrative.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se këtij debati dhe kësaj situate të pakëndshme nuk i gëzohet personalisht, por në tri vitet e fundit në të njëjtën gjendje ka qenë vetë ai, për shkak të mos dëgjimit të zërit të tij dhe përdorimit të arrogancës së numrave në kuvend. Për sa i përket pikës që është në shqyrtim në rend të ditës, duhet korriguar emërtimi si Gjykata Komunale dhe jo gjykatë e komunës. Në referim të rapporti të kompanisë për vlerësimin e këtij objekti citojmë: që të ruhet objekti në fjalë me arsyetimin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, bazuar në gjendjen e objektit në global mund të themi se është e mundshme. Deri me tanë nuk kemi një kërkesë nga dikasteri i kulturës, për futjen në mbrojtje në trashëgimin kulturore të këtij objekti, dhe se ai personalisht nuk ka ndonjë ndjenjë të mirë për atë objekt. Pastaj ai vlerësoi se nëse dikush ka ndonjë ide, për këtë objekt për destinimin dhe shfrytëzimin e saj është mirë të bën të ditur atë, mirëpo sa po shihet nuk ka ndonjë ide se për çfarë do të mund të shfrytëzohet ky objekt komunal, në të kundërtën nuk duhet të kemi qasje paragjykuese dhe kundërshtuese për këtë objekt. Ky objekt mund të qëndroj si tillë, por nëse dikush mendon që të intervenoj në muret e brendshme atëherë qëndrueshmëria e tij lëkundet, për shkak të konstruktit të ndërtimit që ka si ndërtim jo skeletor.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se për këtë çështje nuk janë zbatuar procedurat ligjore, që lidhen me diskutimin publik, pastaj ekzistojë incizime, që perona të caktuar janë dërguar, aty për ta dëmtuar atë objekt me qëllim që të vjen deri të situata që ky objekt të rrënohet, për këtë janë njoftuar organet kompetente të sigurisë.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-vlerësoi se për të dal nga kjo situatë propozoi që për këtë çështje të mbahet një diskutim publik, ku do të merrnin pjesë përveç qytetarëve edhe persona profesional nga kjo fushë, kjo do na ndihmonte të kemi një pasqyrë të përgjithshme si duhej vepruar, se a duhet të zbatohet vendimi për dhëni e kësaj prone në shfrytëzim apo duhet ndërmarr hapa tjerë.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi se në mbledhjen e kaluar të kuvendit, ishte prolonguar kjo pikë e rendit të ditës me arsyetimin se nuk është përfshirë pika lidhur me shfuqizimin e vendimit i cili e kishte dhënë në shfrytëzim këtë pronë. Në atë mbledhje nuk kishte pasur insistim dhe kishte pasur një pajtueshmëri që kjo temë të trajtohet e analizohet mirë duke u shfuqizuar vendimi i cekur më lartë dhe duke u përfillur të gjitha procedurat ligjore. Që nga janari i viti 2019 kur është marrë vendimi për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim e deri me tanë që kanë kaluar më shumë se dy vite nuk ka pasur asnjë të interesuar për ta marrë në shfrytëzim këtë pronë edhe pse vendimi ka qenë i publikuar në listën e pronave për dhënien në shfrytëzim i afishuar në faqen zyrtare të komunës. Në vitin e kaluar kemi një raport nga Drejtoria e Emergjencave që objekti po shkatërrohet dita ditës, e po ashtu kemi edhe njoftimi nga Drejtoria e Inspektiveve se ky objekt paraqet rrezik për qytetaret e komunës sonë. Pastaj është formuar një komision intern nga kryetari i komunës, për vlerësimin e gjendje së këtij objekti, dhe po ashtu nga komisioni është kërkuar që kemi kontraktimin e një kompanie të specializuar për marrjen e mostrave të betonit, armaturës dhe tullave dhe kjo është realizuar.

Nezir Klinaku, anëtar i KK-së – Ajo që desha ta them në mënyrë që ta dinë edhe qytetarët e Vushtrisë është se Kryetari i Komunës dhe Lëvizja Vetëvendosje po veprojnë me dy standarde

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se sistemi që është përdor në këtë objekt është sistem masiv me mure mbajtëse, por në disa pjesë ka edhe shtylla nga betoni i armuar. Pikërisht në këtë shtylla nga betoni i armuar janë marrë mostrat nga kompania e licencuar, ku në raport janë paraqitur të dhënat që fatkeqësisht tregojnë për kualitetin e dobët të betonit, të armaturës, por edhe të tullave që janë përdor në këto mure mbajtëse.

Pas tërmetit të Shkupit, ka ndryshuar Eurokodi i ndërtimit, ku aplikohen tjera standarde të ndërtimit. Ai tha se objekti i gjykatës është i ndërtuar në vitet 1960/61, kurse konstruksioni meskatësh është sistem avramenko, ku ka distanca të mëdha në mes këtyre mureve mbajtëse, por ka distanca të mëdha edhe te disa shtylla që janë aplikuar në atë kohë. Për këto arsy, kompania që e ka bërë vlerësimin e objektit, ndër rekomandimet tjera ka thënë se nuk guxon të bëhet asnjë ndryshim i vetëm as në mure e as në shtylla. Lidhur me diskutimet që u cekën, ai tha se ka pranuar tri emala ku thuhet se ka interesa personale dhe do të futet në zonë ndërtimore. Ne kemi të aprovuar një Plan Zhvillimor Komunal në vitin 2017 që është i vlefshëm deri në vitin 2024, ku është përcaktuar saktë zona ndërtimore. Në vitin 2016 është dorëzuar një draft nga organizata CHËB për Zonën Historike, ku është përcaktuar kufiri i saj dhe ne jemi duke e vazduhar këtë draft dhe shumë shpejt do të fillojmë me diskutime publike. Objekti për të cilin po diskutojmë është i futur në zonën ndërtimore, por i takon zonës historike, që do të thotë do të ketë ndërtim të ultë (P+1). Ai tha se prej që është drejtor, asnjë leje ndërtimore nuk është dhënë në zonën historike.

Lidhur me diskutimet që u bënë se janë lëshuar leje për terrasat e dyqaneve në rrugën “Galip Badivuku”, ai tha se është e vërtetë se qëllim ka qenë përkrahja e bizneseve. Kemi lëshuar pëlqime të përkohshme, sepse në kuvendi komunal e sheh të arsyeshme që së paku 150 punëtorë t'i lëmë pa punë, atëherë me një vendim i anulojmë të gjitha ato pëlqime.

Standardi i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) po shihet se është i dyfishtë, ku për shkollën në Stanoc kërkojnë që mos t'i jepet një biznesi, kurse për ish objektin e gjykatës thojnë po, sepse sipas informatave që kemi ka pasur interesim nga aktivistë të LVV-së për ta shfrytëzuar këtë objekt.

Ilmi Azemi, anëtar i KK-së – konsideroj se debati për këtë pikë është konsumuar. Andaj, kérkoj që ta hudhni në votim.

Gresa Muli, anëtare e KK-së – kérkoj që të respektohet edhe propozimi im për me qit këtë pikë në debat publik dhe të votohet edhe ajo pjesë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi me 22 vota “për”, 9 “kundër” dhe 1 “abstenim” vendosi me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim lejohet rrënimi i objektit të ish Gjykatës Komunale në Vushtrri i cili gjendet në parcelën kadastrale me nr. P-70202016-00129-0 në vendin e quajtur “Varosh Marshalla Tita” e cila përfshinë një sipërfaqe prej 473 m².**
- 2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.**
- 3. Me këtë vendim shfuqizohet pika 1.3 e Vendimit Paraprak 22/19 e datës 31.01.2019 lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.**
- 4. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**
- 5. Shqyrimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sheshit të Pavarësisë në Vushtrri.**

Ilmi Azemi, anëtar i KK-së – ai propozoi që pas nenit 1, të bëhet edhe një nen i ri (neni 2) që ta ketë këtë përbajtje: “Sheshi në brendinë e tij duhet t’i ketë të vendosura, në njëren anë Deklaratën e Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë dhe në anën tjetër Deklaratën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, me zgjedhje dhe vendosje artistike, sipas përzgjedhjes së përcaktuar me anë të konkursit publik

Nezir Klinaku, anëtar i KK-së – theksoi se s’po shoh të arsyeshme të xhirojmë filma me deklarata të pavarësisë në 4 ari, por aty ekziston sheshi “Adem Jashari” dhe pas rrënimit të objektit, ajo sipërfaqe mund t’i bashkëngjitet sheshit “Adem Jashari” dhe nuk kemi nevojë të caktojmë lokacion për shesh t’i ri.

Xhafer Tahiri, kryetar i Komunës – që nga ardhja jonë në komunë, kur e kemi marrë raportin e performancës, ku një nga vlerësimet e dobëta në këtë raport ka qenë mungesa e hapësirave publike dhe shesheve. Prandaj, jam i lumtur që po krijojmë mundësinë për sheshin e tretë në qendër të qytetit. Është e vërtetë që është bashkë me sheshin “Adem Jashari”, por po e krijojmë mozaikun e lirisë dhe të pavarësisë me këto sheshe si: “Hasan Prishtina”, “Ahmet Krasniqi”, “Adem Jashari” “Sheshi i Pavarësisë”, që i japin kuptimësinë Vushtrrisë me vizionin e qytetit historik. Ai tha se po më pëlqen ideja e Ilmiut që të vendosen deklaratat e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Kosovës që ja rritin vlerën këtij sheshi. Përveç qytetit, ne kemi filluar ndërtimin e shesheve publike në 7 fshatra.

Hajriz Mustafa, anëtar i KK-së – përderisa nuk u dëgjuia zëri ynë dhe nëpërmes neve nuk u dëgjuas as zëri i qytetarëve që ky objekt të shkoj në dëgjim publik.

Drejtori tha se një aktivist i LVV-së ka pasë qëllim ta marrë në shfrytëzim këtë objekt, ne kërkojmë që ta thotë me emër, sepse unë nuk e di.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – nuk duhet t’i flitet me paranoja, sepse ju LVV-ja keni filluar të flisni në këtë mënyrë. Flisni fillimi shi me emra se për çka kanë filluar të bëhen këto zhvillime, pastaj flasim edhe ne me emra.

Hajriz Mustafa, anëtar i KK-së – paranojak jam quajtur atë ditë pse e kam bërë një pyetje qytetare në kuvend, ku qytetarët e Stanocit kanë pyetur se çka është kah ndodhë në shkollë.

Drejtori i juaj, tani në cilësinë e nënkyetarit më quajti edhe paranojak edhe më tha se po luan ashpër, ai më tha me një gjuhë tjetër <korlaçki>

Ymer Haradinaj, anëtar i KK-së – tha se tash më erdh një shkresë nga Fevzi Igrishta, banor i fshatit Stanoc i Poshtëm, i cili më datën 3 korrik 2019 ka bërë një kërkesë te kryetari i Komunës dhe te drejtoria përkatëse që t'i ipet në shfrytëzim një pronë. Ky qytetar ka dorëzuar edhe projektin përrregullimin e një kompleksi sportiv në një parcelë që është pronë e komunës. Ai thotë se nuk ka marrë përgjigje lidhur me kërkesën e tij.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se e dimë se si funksionon ligji për dhënien në shfrytëzim të pronave dhe se nuk mundemi me një kërkesë ta japim në shfrytëzim pronën. Ai tha fillimisht bëhet një listë paraprake e pronave publike dhe votohet në kuvend, pra ajo listë sot është publike në web faqe të komunës.

Ai tha se përgjigje i kemi kthyer palës, madje edhe e kemi pritur në takim dhe është ndarë i kënaqur me përgjigjen që ia kemi ofruar.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi me 22 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 “abstenim” vendosi sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Sheshit të Pavarësisë në Vushtrri, në parcelën kadastrale P-70202016-00129-0, në sipërfaqe prej 473 m² Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e PSH Gjykata Komunale, (shfrytëzues në afat prej 99 nëntëdhjetë e nëntë viteve Komuna e Vushtrrisë).
2. Sheshi i Pavarësisë në brendësin e tij duhet ti ketë të vendosura, në njérën anë Deklaratën e Pavarësisë të Republikës së Shqipërisë dhe në anë tjetër Deklaratën e Pavarësisë të Republikës së Kosovës, me zgjedhje dhe vendosje artistike, sipas përzgjedhjes të përcaktuar me anë të konkursit publik.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë :certifikata për të drejtën e pronësisë dhe kopja e planit.
5. Ky vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
6. Shqyrimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – theksoi se është bërë një gabim teknik te <investimet kapitale - ndërtimi i kiosqeve>, ku në vend të sheshit “Adem Jashari” është shënuar sheshi “Hasan Prishtina”.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanëmisht” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditje.....	1,333.80 €
1.2 Mallra dhe shërbime	601,064.11 €
1.3 Shpenzimet komunale.....	25,341.22 €
1.4 Subvencionet dhe transferet.....	225,304.93 €
1.5 Investime kapitale.....	936,207.77 €
Totali i mjeteve të bartura.....	1,789,251.83 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale, dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimi në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2021.

Nezir Klinaku, anëtar i KK-së – tha se te paragrafi 1.4, nënparagrafi 1.4.6 <kompensimi për fëmijët e porsalindur dhe Covid – 19>, ndoshta do të ishte më mirë të sqarohet, sepse ekzistojnë vendimet e kuvendit dhe t'i shtohet sipas vendimit të kuvendit.

Xhafer Tahiri, kryetar i Komunës – pra, siç po e shihni, vendimi i kuvendit po materializohet me mjete financiare. Prandaj, vetëm të përmirësohet dhe të bëhet sipas vendimit të kuvendit dhe është në rregull.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanimisht” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim mjetet financiare të buxhetit të Komunës – subvencione dhe transfere të vitit 2021 në shumë të përgjithshme prej 790,000.00€, shpërndahen sipas pozicioneve të cekura si më poshtë:

1.1 Zyra e Kryetarit:

1.1.1 Subvencione për dekorata.....	30,000.00 €
1.1.2 Subvencione për raste të veçanta (për kompensimin e bizneseve, fatkeqësive natyrore etj.).....	140,000.00 €

Gjithsej.....170,000.00 €.

1.2. Zyra Komunale për Komunitete (ndihmë për të riatdhesuar).....5,000.00 €.

1.3. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (Subvencionimi i projekteve në bujqësi).....145,000.00 €.

1.4. Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

1.4.1. Ndihmë për strehim – qiratë e banimit20,000.00 €

1.4.2. Ndihmë për shërim.....28,000.00 €

1.4.3. Ndihmë për familje skamnore.....10,000.00 €

1.4.4. Financim të OJQ – ve.....27,000.00 €

1.4.5. Bashkëfinancim me donatorë për familje të pastrehë.....15,000.00 €

1.4.6. Kompensimi për fëmijët e porsalindur si dhe për të infektuarit nga pandemia Covid-19..... 180,000.00 €

Gjithsej.....280,000.00 €

1.5. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:

1.5.1. Botimi i Librave – publikimeve 5,000.00 €

1.5.2. Financimi i OJQ- ve125,000.00 €

1.5.3. Teatri i qytetit10,000.00 €

Gjithsej.....140,000.00 €

1.6. Drejtoria për Arsim

1.6.1. Bursa për studentë.....22,000.00 €

1.6.2. Transport për fëmijë me nevoja të veçanta.....18,000.00 €

1.6.3. Bursa për nxënës të klasës së X –të, drejtimi – saldues dhe përpunues i drurit në SHMT “Lutfi Musiqi”.....5,760.00 €

1.6.4. Shpërblime për nxënës4,240.00 €

Gjithsej.....50,000.00 €

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte, Drejtoria për Arsim dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2020/2021.

Ymer Haradinaj, anëtar i KK-së – theksoi se informata më e mirë është që ish – drejtori i arsimit më nuk është drejtor në këtë drejtori, sepse jemi të shqetësuar me gjendjen në arsim të cilën e ka sjellë ai gjatë mandatit trevjeçar. Sa i përket informatës, është një kopje nga vitet e kaluara. Si prind, por edhe si qytetar jemi të shqetësuar me gjendjen në arsim sa i përket gjysmëvjetorit të parë, sepse ka munguar ngrohja, si pasojë e mungesës së lëndëve djegëse në shumë shkolla. Si pasojë e kësaj, nga të ftohtit kemi pasur edhe fëmijë të sëmurë. Kërkoj nga drejtoresha e re që mos të përsëriten gabimet e tillë, por që shkollat të furnizohen me lëndë djegëse në kohë optimale. Ai tha se në këtë informatë nuk ka asnje fjalë për gjendjen e mësimdhënësve në kohë të pandemisë. A pyeti se ka pasur mësimdhënës që kanë humbur betejën me Covid 19? Sa ka qenë numri i mësimdhënësve të infektuar? Cila është gjendja reale? Punëtorët teknikë të tri shkollave të mesme, sikurse mësimdhënësit i nënshtrohen rrezikut permanent për infektim me Covid 19, nuk i kanë marrë shtesat prej 100 euro që i ka vendosur Ministria e Arsimit. Prandaj, kërkojmë që edhe këta punëtorë teknikë të përfshihen në këto shtesa në mënyrë që edhe ata ta gjelqojnë këtë të drejtë. Në Shkollën e Mesme Profesionale kemi shtatë mësimdhënës me titull Master që iu mohohet e drejta e pagesës së këtij titulli. Ai kërkoi që të shqyrtohen këto raste dhe këta shtatë mësimdhënës të paguhen sipas titullit. Gjatë kësaj periudhe kohore, të gjithë mësimdhënësve të komunës sonë (anëtarë të sindikatës) iu është mohuar e drejta sipas Kontratës Kolektive për pagesën e shujtës dhe shpenzimeve të rrugës. Ata të shtyrë nga kjo gjendje kanë angazhuar avokatë që këtë të drejtë ta realizojnë përmes gjykatës, duke u dëmtuar buxheti i komunës dhe mësimdhënësve. Ai kërkoi nga Drejtoria për Arsim që këtë çështje ta merr me prioritet dhe mos t'i lejoj mësimdhënësit t'iu drejtohen gjykatave dhe të krijojnë shpenzime shtesë. Ai pyeti drejtoreshën e re të arsimit se cila është përvoja e saj si menaxhere dhe a ka përvojë në procesin edukativo – arsimor?

Ilmi Azemi, anëtar i KK-së – edhe unë sikurse parafolësi jam i njofuar me kërkuesat ligjore të mësimdhënësve, ku disa prej tyre veç i kanë siguruar dëshmitë nga disa kompani të transportit dhe po i dorëzojnë paditë kundër komunës për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit. Ai tha se kemi një përvojë të keqe me shujta, ku komuna pa fajin e saj ka humbur rreth 300 mijë euro. Prandaj, është mirë që këto mjete financiare t'iu alokohen secilit mësimdhënës në bazë të relacioneve të udhëtimit që kanë dhe dëshmitë t'i dorëzojnë në komunë e jo në gjykatë dhe t'iu ikim shpenzimeve shtesë dhe se do të dëmtohet komuna dhe projektet investive zhvillimore.

Prandaj, të gjendet një formë në bashkëpunim me ministrinë që mos të dëmtohet buxheti i komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i KK-së – nëse Afrim Namani ish-drejtori i arsimit e ka degraduar arsimin në Komunën e Vushtrrisë, atëherë i bie që kjo ka ndodhë sa ka qenë në bashkëqeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje. Nëse për diçka është përfolur Afrim Namani në Vushtrri është përfol që po i punëson gratë e drejtorëve të Vetëvendosjes. Ai tha se drejtoreshës së re i dëshiron sukses në detyrën e re dhe se nuk besoj që duhet me pasur përvojë të madhe për me menaxhuar një drejtori.

Melihate Basholli Latifi, anëtare e KK-së – duhet të kemi kujdes se çka diskutojmë sepse nuk jemi vetëm sot këtu dhe e dimë veprimtarinë e secilit. Konsideroj se kjo informatë është e mangët dhe sipërfaqësore. Edhe në KPF e kam thënë që nuk duhet të jetë gjysmëvjetori, por të jetë me periudha. E keni marrë këtë vërejtje dhe e falënderoj që një herë në këtë mandat më ka thirr një zyrtar prej drejtorisë dhe më ka jep sqarime. Ai më tha se është një gjeneratë që është me gjysmëvjetor dhe kjo ka qenë arsyaja që është bërë ky emërtim. Por, prapë nuk jam e kënaqur me këtë, sepse aty ku janë shumica duhet të trajtohet lënda dhe se shumica janë me periudha. Unë si punëtore e arsimit po ndihem keq, sepse aspak nuk është vlerësuar puna jonë në këtë periudhë

(kohë e pandemisë). Ta marrim vetëm një pikë këtu: <Të gjitha shkollat janë pajisur me termometër laserik> Ne si mësimdhënës është dashur ta kryejmë edhe punën e infermierëve. Në anën tjetër, ne jemi shkollë e madhe dhe vetëm një herë kemi marrë termometër laserik dhe nuk e di që është përsëritur kjo, por çdo herë kemi pasur probleme me teknikë. E dimë që ky virus ka qenë i panjohur, por puna në arsim duhet të shikohet me një këndvështrim tjetër. Kemi pasë shumë probleme me mësimdhënës të infektuar, e sidomos me zëvendësimin e tyre, kur Drejtoria për Arsim nuk ka pasur mundësi ta bëjë një gjë të tillë. Ka pasur raste që pasi që e kemi kryer Covid-in, ashtu të dobët me shëndet, që përvèç punës sonë, është dashur ta kryejmë edhe punën e kolegëve që kanë qenë të infektuar.

Prandaj, këto çështje të paktën është dashur të përfshihen në këtë informatë. Sa i përket shujtës dhe shpenzimeve të udhëtimit, e kam thënë edhe më herët që ndihem keq që është dëmtuar buxheti i komunës, por në anën tjetër jam ndjerë edhe më keq me këndvështrimin që e kanë pasur të gjithë njerëzit për mësimdhënësit. Shumë pak njerëz kanë qenë që e kanë trajtuar mësimdhënësin të dëmtuar me vite e dekada për këtë punë. Ne si mësimdhënës i kemi dorëzuar dokumentet edhe për kompensim të udhëtimit dhe fatkeqësisht do të dëmtohet buxheti i komunës, sepse këto konteste po përfundojnë në favor të të drejtit (mësimdhënësit).

Habibe Gérxhaliu, anëtare e KK-së – ato që desha t'i them i tha parafolësja, sepse ndihemi keq si mësimdhënës që po e dëmtojnë komunën tonë për realizimin e të drejtave tona. Ajo pyeti se pse disa mësimdhënës i kanë realizuar të drejtat e tyre e disa ende jo? Po ashtu, ajo pyeti se pse u ndërpri testimi i mësimdhënësve?

Afrim Namani, nënkyetar i Komunës – pasi që jam nënshkrues i informatës, atëherë po e marrë fjalën për t'iu dhënë përgjigje disa pyetjeve që u ngritën. Çështja e të infektuarave ndoshta është dashur të përfshihet në informatë, por takimet e shpeshta me task forcën komunale edhe me task forcën e shkollave është diskutuar çdo herë. Numri i saktë i të infektuarave si i mësimdhënësve, nxënësve, i punëtorëve teknikë dhe stafit administrativ që nga fillimi i pandemisë e deri më sot përditësohet çdo ditë në Drejtorenë për Arsim. Ai tha se çdo ditë i përcjellët raporti Inspektoratit të Arsimit në Mitrovicë. Punëtorët teknikë që nuk e kanë marrë shtesën prej 100 eurove bëhet fjalë për punëtorët që janë të angazhuar në shkolla, por që punojnë në sektorin privat. Regjistri për të gjithë, duke përfshirë edhe këta punëtorë ka shkuar në qeveri, por qeveria nuk i ka ekzekutuar. Ne si DKA e kemi kryer punën tonë, madje kam biseduar edhe me kryetarin e sindikatës në Vushtrri dhe i kam thënë që ta ushtroj ndikimin e tij që edhe këta punëtorë të kompensohen. Ai tha se nuk e di që është ndërpërë mësimi në ndonjë shkollë pse s'ka pas ngrohje, por kjo vonesë ka ndodhë për shkak të procedurave të prokurimit dhe ankesave, por sasi të drunjtëve ka pasur që asnjë shkollë mos ta ndërprijë mësimin. Shtatë mësimdhënësit me titullin Master i kam pasur në zyrë dhe disa herë lënda e tyre është përcjell në Ministri të Financave për pagesën, por ministria asnjëherë nuk i ka pranuar lëndët e tyre, pasi që sipas tyre ka disa probleme me dokumentacionin. Ai tha se çdo herë që kemi marrë një vendim në lidhje me mësimin në këtë kohë, e kemi konsultuar fillimisht task forcën e shkollave e pastaj në task forcën komunale kemi marrë vendim. Lidhur me zëvendësimin e mësimdhënësve, ai tha se ku ka pasur mundësi është bërë zëvendësimi nga mësimdhënës tjerë, dhe se sipas masterplanit mund të angazhohen edhe me gjysmë norme, sepse nuk lejohet të rritet numri i punëtorëve. Në shkollën e parafolës, kemi pasur mundësi me sjell arsimtar për kimi edhe të lirohen mësimdhënësit mos me e mbajt dyfishin e orëve dhe asnjëri prej tyre nuk ka pranuar dhe kanë thënë që orët i mbajmë vet. Çështja e shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit është trajtuar shumë. Vetëm për shujta brenda vitit për punëtorët e arsimit nevojitet rreth 500 mijë euro, kurse Drejtoria për Arsim aktualisht ka të aprovuara vetëm 450 mijë euro në kategorinë mallra dhe shërbime. Ai tha se bashkë me kryetarin iu kemi shkruar shkresë ish ministrit

të Financave, Besnik Bislimi dhe ish ministres së Arsimit, Hykmete Bajrami se nëse nuk ndërmerrat diçka në këtë drejtim, atëherë ekziston rreziku që Drejtoria për Arsim mos të mund t'i zhvillojë dhe përbush aktivitetet e veta për shkak të mungessës së mjeteve financiare. Ai tha se mësimdhënësit po dëmtohen nga kryetarët e shoqatave sindikale nëpër shkolla, sepse SBASHK-u iu ka ofruar ndoshta avokatë falas, por këta nuk kanë pranuar.

Melihate Basholli Latifi, anëtar i KK-së – theksoi se në bazë të asaj që e tha nën kryetari i komunës janë bërë më shumë punë që nuk janë përfshirë në informatë. Prandaj, kjo informatë do të duhej të ishte më e plotë.

9. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës për Punë Sociale;

Ilmi Azemi, anëtar i KK-së – tha se shpresoj që ky dokument ka kaluar përmes zyrës ligjore dhe si i tillë do ta ndihmonte këtë institucion për kryerjen e veprimtarive të përditshme, prandaj në parim e përkrahim.

Gresa Muli, anëtar e KK-së – e kam lexuar me vëmendje këtë draft – statut dhe është mirë që më në fund po bëhet me statut Qendra për Punë Sociale. Atë që e kam parë dhe që mungon që të ceket në këtë draft është puna pas orarit (me ndërrime) që bëjnë zyrtarët e kësaj qendre.

Nezir Klinaku, anëtar i KK-së – nëse është puna për me përgëzu, e kisha përgëzuar Komunën e Klinës për këtë draft – statut. Ky draft është kopjuar nga Komuna e Klinës, ku me pikë me presje, nene, madje edhe gabime drejtshkrimore, përveç në nenin 5, paragrafi 2 në draft- statutin e QPS-së Vushtrri iu ka shtuar kjo: <Qendra për Punë Sociale kryen dhe ofron shërbime të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale> në bazë të Ligjit për Skemat e Ndihmave Sociale nr. 2003/15. Iu kisha sugjeruar që le ta shtojnë edhe Ligjin 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, ku ligji bazik prej 17 neneve sa i ka pasur, 16 prej tyre janë ndryshuar me plotësim-ndryshim.

Xhafer Tahiri, kryetar i Komunës – po më njoftojnë që draft-statutet e Qendrave për Punë Sociale janë bërë unike për të gjitha komunat për shkak se kanë të njëjtin mandat ligjor.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi me 21 vota “për”, asnje “kundër” dhe 1 “abstenim” aprovoj Statutin e Qendrës për Punë Sociale.

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Ndërmarrjes regionale “Uniteti”;

Xhafer Tahiri, kryetar i Komunës – dua t'i falënderoj qytetarët e Vushtrrisë për një aktivitet që e kemi nisur <ndarja e mbeturinave të riciklueshme në burim> Nëse e shihni reportin, do ta shikoni se Vushtrria ka deponuar mbeturina në deponi këtë vit rrëth 30 ton më pak. Prej 4097 ton që janë deponuar në vitin 2019, në vitin 2020 kemi deponuar 3974 ton. Prandaj, kjo është si rezultat i faktit që po funksionon ndarja e mbeturinave të riciklueshme dhe kemi 1500 familje në Vushtrri që e kryejnë këtë aktivitet për çdo ditë, “Uniteti” që e mbledh dhe fabrika në Bukosh që e paketon dhe e shet dhe është rezultat edhe në shkolla nga klubet e gjelbërta dhe drejtoritë e shkollave për vetëdijësimin në ruajtjen e ambientit. Prandaj, dua ta falënderoj kompaninë “Uniteti”, drejtorin, bordin, njësinë në Vushtrri dhe secilin veç e veç për punën e madhe që kanë bërë gjatë pandemisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, unanimisht kuvendi aprovoj Raportin vjetor të Ndërmarrjes regionale “Uniteti”.

11. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr.01-35/21 i datës 25.02.2021, për shtyrjen e afatit të pagesës së këstит për lejet ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se ky vendim është aprovuar në mbledhjen e kaluar, por MAPL ka kërkuar që tek baza ligjore të shtohet edhe një nen duke u thirrur në Planin Zhvillimor Komunal, kurse pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim lejohet shtyrja e afatit të pagesës së këstit për leje ndërtimore për objektet e kategorisë së dytë.**
- 2. Afati për shtyrjen e pagesës së këstit bëhet për tre (3) muaj nga dita e arritjes së obligimit për pagesë.**
- 3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.**
- 4. Ky vendim hyn fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

12. Shqyrtimi i peticionit i parashtruar nga banorët e lagjes “Kalaja”;

Ismail Haziri, kryetar i lagjes urbane “Kalaja” – tha se në këtë mbledhje ka ardhur me qëndrim të kryesisë së lagjes dhe të familjes “Haziri”. Kam ardhur ta shpreh shqetësimin e banorëve për mosrespektimin e ligjit nga ana e organeve komunale. Në vitin 2013, Bashkësia Islame në Vushtrri ka bërë kërkesë për ndërtimin e një xhamie ngjitet me sallonin e vëllaut. Pas reagimit të banorëve, Drejtoria për Urbanizëm ia ka refuzuar kërkesën se nuk ka hapësirë për ndërtimin e xhamisë. Ai tha se edhe përkundër kësaj, aty njerëzit po falen në atë objekt edhe se po na e bllokojnë rrugën tonë. Pas kërkesave dhe peticioneve të vazhdueshme, kuvendi komunal e pati autorizuar kryetarin Bajram Mulaku që të bëjë një zgjidhje në mes banorëve dhe Bashkësisë Islame. Më 7 maj 2014 ishte arritur një marrëveshje që brenda 3 muajve, ajo shupë e improvizuar, e ashtuquajtur xhami të mbyllët dhe të transferohet diku tjetër. Por, kjo nuk është duke u zbatuar dhe se edhe sot kemi probleme. Nuk jam kundër xhamisë, por ajo të ndërtohet në një vend adekuat. Kërkojmë nga organet komunale që ta zgjidhin këtë çështje në mënyrë institucionale sa nuk është bërë ndonjë e keqe, në të kundërtën përgjegjësia do të bie tek organet shtetërore.

Ilmi Azemi, anëtar i KK-së – tha se ky shqetësim po na përcjell me vite. Në mandatin e kaluar kuvendi e pat themeluar një komision në mënyrë që ta gjejnë një zgjidhje për këtë çështje. Me Bashkësinë Islame e patëm arritur një marrëveshje dhe ua kemi ndarë truallin për ndërtimin e xhamisë afér zjarrfikësve dhe në afatin prej tre muajve të largohen prej atij objekti që shërben për faljen e namazit, sepse ajo nuk është xhami dhe po shfrytëzohet në mënyrë ilegale. Ata as nuk e kanë marrë truallin, por as nuk janë larguar prej aty. Komuna ka treguar pafuqi, por ndoshta edhe mosinteresim për zgjidhjen e kësaj çështjeje, sepse konsideroj se ka mundësi për zgjidhje pasi që është kompetencë ekskluzive e komunës. Prandaj, sot është mirë të marrim një qëndrim apo të

formojmë një komision miks (kuvend – qeveri) dhe në bashkëpunim me Bashkësinë Islame ta zgjidhim këtë problem.

Nezir Klinaku, anëtar i KK-së – sa jam në dijeni, as xhamiat e as kishat nuk kërkojnë leje të përdorimit nga shteti. Prandaj, ky qytetar qe 8 vjet po merret me të njëjtin problem dhe po diskutohet në kuvend. Unë nuk jam kundër fesë, por kërkoj që t’iu bëhet zgjidhje qytetarëve.

Agim Bregaj, anëtar i KK-së – tha se ish kryetari i Komunës Bajram Mulaku e ka marrë për obligim me kry këtë punë.

Faton Shabani, anëtar i KK-së – pyeti se si kuvend a kemi të drejtë të ndërhyjmë në këtë çështje a jo?

Ali Januzi, anëtar i KK-së – tha se pak a shumë e njoh historikun e kësaj ngjarje. Ajo pronë ka qenë e Hysen Hysenit nga fshati Popovë. Sa e di (nuk jam shumë i sigurt), por Hysen Hyseni nuk ka pasardhës, por e ka lënë si testament që të ndërtohet aty një xhami. Sa ka qenë Bajram Mulaku, e di që ua ka ofruar një parcelë në rrugë të Studimes për ndërtimin e xhamisë. Por, ka edhe mundësi tjera këtu. Të shitet ajo parcelë dhe me ato mjete financiare të ndërtohet xhamia në një parcelë tjetër që do t’ia ofronte komuna. Prandaj, në njëfarë formë të dy palët janë bllokuar.

Edhe unë po pajtohem që të themelohet një komision dhe në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të gjendet një zgjidhje.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi me 21 vota “për”, vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim themelohet komisioni i përbashkët kuvend-qeveri komunale në përbërjen si në vijim:

- 1.1.Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit;
- 1.2.Ali Januzi, anëtar i kuvendit;
- 1.3.Agim Kraniqi, anëtar i kuvendit;
- 1.4.Agron Përçuku, drejtor i Drejtorisë së Inspektiveve dhe
- 1.5.Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

2. Komisioni i cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të ketë për detyrë, që në bashkëpunim me Bashkësinë Islame të Kosovës Dega në Vushtrri, të konstatoj gjendjen faktike lidhur me Xhaminë e cila ndodhet në lagjen urbane “Kalaja” Rr. “Istref Haziri” Nr. 9, duke gjetur një zgjidhje të qëndrueshme dhe duke adresuar shqetësimet e banorëve, që banojnë në lagjen e cekur më latë të shprehura përmes peticionit të parashtruar në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë.

3. Komisioni i lartë cekur, obligohet të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjate të kësaj problematike, konform legjisacionit në fuqi, duke i përligjur shqetësimet dhe interesat e banorëve të asaj lagje dhe pas përfundimit të këtij procesit të ofroj një raport të shkruar Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: komisioni i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

13. Shqyrtimi i peticionit të parashtruar nga banorët e fshatit Stanoc i Epërm, lidhur me kundërshtimin e marrëveshjes në mes kryetarit të komunës dhe fabrikës së tekstilit “VITEX” për shfrytëzimin e objektit të vjetër të Shkollës Fillore “Migjeni”, për qëllime biznesore;

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-propozoi që për çështjen e hapjes së fabrikës në objektin e shkollës në fshatin Stanoc i Epërm të mbahet një debat publik, ku do të ftohen banorët lokal por edhe profesionit të fushave të caktuar ku do të merrej një tablo e përgjithshme e mendimeve se si të veprohet. Ai vlerësoi se duhet ti thirrmi arsyes të gjithë në gjuhën e mirëkuptimit ashtu që ti shmangemi konfrontimit të banorëve të fshati Stanoc i Epërm dhe të gjejmë një zgjidhje të pranueshme për të gjithë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-sqaroi ecurinë deri tek lidhja e kontratës një vjeçare mes komunës dhe operatorit ekonomik i cili dëshiron të hap një fabrikë të tekstilit e quajtur VITEX, ku parashihet të hapen 60 vende të reja të punës. Në muajin dhjetor një sipërmarrës me kërkësen në Komunën e Vushtrrisë, duke prezantuar projektin për këtë fabrike për të cilën kishte pasur negociata edhe me Komunën e Mitrovicës. Në vazhdën e negociatave me këtë sipërmarrës të cilin nuk e kishte njojur me herët, e kishte konsultuar drejtorin e DA-së, si cili nga objekte e vjetra të shkollave do të mund të shfrytëzohej për këtë qëllim, kjo për faktin se objektet e vjetra të shkollave po shkatërrohen në mungesë të investimeve, në këtë rrafshështë biseduar për shkollën e fshatit Sllatinë, madje Maxhunaj, për shkollën e Pantinës dhe në fund është përmendor shkolla e fshatit Stanoc i Epërm, ky investitor ka shkuar dhe i ka vizituar këto shkolla fillimisht atë në fshatin Sllatinë që është vlerësuar se është larg dhe kostoja financiare është e lartë, pastaj atë në Maxhunaj, që ka pasur gatishmëri nga komuniteti lokal, pas konsultave që ka pasur me Këshillin e Fshatit, por që operatori ka vlerësuar se duhet ndërtuar një rrugë për të mos i penguar nxënësit e shkollës, pasi kjo ka qenë kusht nga ana e komunës. Krejt në fund është vendosur që ky operator të vendoset në fshatin Stanoc i Epërm. Duke parë zbrazëtirat ligjore, është iniciuar hartimi i rregullores për dhënen e pronës në shfrytëzim dhe kjo çështje është përfundua gjatë muajit janar 2021 me qëllim që të mundësohet që ligjërisht këto prona të jepen në shfrytëzim. Pasi është bërë përvimi i objektit të ri shkollor në fshatin Stanoc i Epërm, është menduar që objekti i vjetër shkollor të shfrytëzohet për hapjen e kësaj fabrike, pasi që objekti i ri i shkollës mund të përdoret edhe për bibliotekë,, çerdhe dhe kënd leximi, ndërsa niveli parashkollor funksionin tanë në po atë shkollë. Pretendimi se objekti i vjetër i shkollës të përdoret përmes apo çerdhe është i paqëndrueshëm sepse po të shërbente ai objekt për çështje edukativ-arsimore nuk do të kishte pasur arsyë të ndërtohet objekti i ri shkollor. Pastaj ai sqaroi planin e investimit dhe konfiguracionin e qasjes në hyrjen e fabrikës dhe të shkollës, ku këto dy objekte do të kenë dy hyrje të veçanta dhe të ndara nga njëra tjetra. Sa i përket fushës sportive ajo është planifikuar të ndërtohet në buxhetin e komunës për këtë vit në vendi ku ajo sot ndodhet e njëjtë do të rinovohet. Ndërsa Këshilli i Fshatit i cili po thirret në interesin e përgjithshëm nuk ka bërë asnjë të mirë për oborrin e shkollës nuk ka mbjell asnjë lule asnjë pemë asnjë veprim të duhur për shkollën veç pengesave. Pas gjithë këtyre çështjeve dhe zhvillimeve, ky i ka lutur asamblistin Ymer Hardinaj, që mos të shkaktojnë pengesa dhe mos të kemi instrumentalizim politik nga ky i fundit dhe disa anëtar të tjerë të nëndegës së LVV-së në Stanoc të Epërm, për të penguar këtë projekt dhe hapjen e 60 vendeve të reja të punës. Tutej janë organizuar dhe kanë ushtruar peticion i cili është dërguar në komunë, me datë 15 mars 2021, por fill pas kësaj i kanë shkruar banorët e fshatit Stanoc i Epërm, duke reaguar se iu është falsifikuar emri dhe numri personal, sepse ky peticion është i kohës, kur këtë banor kanë ushtruar kërkësë për pajisje me kontejner falas nga komuna i njëjtë është falsifikuar dhe është përdorur për këtë çështje. Mungesa e debati publik është si rezultat i gjendjes me pandemi, ku ndalohen tubimet me mbi 30

deri 50 persona, në të kundërtën kjo do të ishte kundër ligjit. Por edhe nëse ai do të mbahej, cila do të ishte arsyja e mbajtjes kur dihet fakti se këto kërkesa të peticionit edhe pse është i falsifikuar i plotëson objekti i ri shkollor, edhe për çerdhe edhe për bibliotekë por edhe për muze. Lidhur me hapjen e çerdhes në këtë fshati ai sqaroi se komuna nuk ka buxhet, për një gjë të tillë pasi që përveç objekti nevojitet edhe pagesa e një punëtori që do të mbikëqyrte atë objekt, pastaj shpenzimet e rrymës dhe mirëmbajtjes dhe shpenzimet tjera. Lidhur me këtë çështje rasti është denoncuar tek organet, policia dhe prokuroria e shtetit për falsifikim të dokumentit. Në fund ai u zotua se është i gatshme të arrij një marrëveshje, por nuk lejon që me peticione fallco të manipulohet opinioni dhe të pengohet hapja e vendeve të reja të punës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se kur ishte çështja e vendosjes së një lokacioni për ndërtimin e një objekti komunal, që është kompetencë ekskluzive e kuvendit, dhe kryetari i komunës fare nuk e pyeste kuvendi, të njëjtët anëtarë të LVV-së që sot po kundërshtoj atëherë deklaroheshin se kryetari po vepron drejt. Tani mund të thuhet se bazuar në rregulloren komunale të hartuar nga koalicioni i deri tashëm LDK-LVV, kryetari i komunës ka vepruar drejt dhe ka dhënë këtë objekt në shfrytëzim që mendohet që do të gjeneroj vende të reja të punës. Por kryetari i komunës nuk ka të drejt të konstatoj që a është falsifikuar një dokument apo jo, sepse këtë e konstaton organet e drejtësisë. Tutje shtoi se nuk është Stanoci i Epërm vetëm i Vetëvendosjes por i të gjithëve, dhe nuk është e ndershme të krijojen kësi lloj konfrontimesh për inate politike. Lidhur me kontratën që është lidhur me operatorin ekonomik, kuvend mund ta autorizoj kryetarin e komunës për ndërprerjen e kësaj kontrate por le ta dinë të gjithë se kjo do të shkaktonte pasoja juridike për komunën që operatori do të paditë komunën për fitimin e humbur.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pasi përshëndeti të pranishmit, tha se ndihet krenar që i përfaqëson banoret e fshatit Stanoc i Epërm qoftë si Kryetar i Këshillit të Fshati apo si asamblist. Duke ju referuar diskutimit të kryetarit të komunës vlerësoi se ai karakterizohet me shumë të pavërteta, dhe sqaroi kronologjinë e çështjes si investimit në objektin e shkollës "Migjeni" në Stanoc të Epërm. Me datën 5 mars, ka parë njoftimin se kryetari i komunës ka dhënë në shfrytëzim këtë objekt kompanisë "VITEX" për një afat prej një (1) viti. Pastaj me të marr këtë informatë, e kanë thirr disa qytetar se a je i informuar për këtë çështje në cilësinë e kryetarit të fshatit, ndonëse një çështje të tillë e kishte ngritur në mbledhjen e kaluar të kuvendi asamblisti nga radhët e LVV-së Hajriz Mustafa. Me datën 6 mars kishte thirrur këshillin e fshatit dhe kishin caktuar termin që takimi të mbahet me 7 mars, por para se të mbahet ky takim kishte thirrur kryetarin e komunës, ku kishte këruar sqarime se përse nuk ishte i informuar ai dhe këshilli i fshatit. Më pasi i kishte deklaruar kryetarit se këshilli i fshatit do të mblidhet shumë shpejt dhe do ta merr një vendim lidhur me këtë çështje. Me 7 mars ishte mbajt takimi i këshillit dhe ishte marr vendim që të kundërshtohet kjo çështje, pasi këshilli kishte vlerësuar se objektet edukativo-arsimore duhet të mbeten të tillë dhe jo të përdoren për qëllime biznesi për fabrika të ndryshme. Kryetari e ka prezantuar se ky pronar është nga komuna e Vushtrrisë, por e vërteta është se pronari legitim është nga Gjurgjevik Komuna e Klinës, është shok i kryetarit të komunës dhe Lulzim Berisha është drejtori Ekzekutiv, kurse Xhelal Ismajli është vetëm si përfaqësuese i kësaj kompanie, këto informata është mirë ti bënë të dituar për opinionin kryetari i komunës. Si këshillë i fshatit kishin këruar mirëkuptimin që të ndërpriten punimet në atë objekt dhe kjo ishte këruar edhe me shkrim. Edhe përkundër këtyre kërkësave kompania ka vazhduar me zhvillimin e punimeve në atë objekt, dhe më pas banoret janë revoltuar që ka ardhur deri te konfrontimi dhe për këtë përgjegjësin e mban kryetari i komunës. Në vazhdim banorët janë organizuar dhe e kanë nënshkruar një peticion që e kundërshton kontratën mes komunës-kryetarit dhe Kompanisë së tekstit "VITEX" për shfrytëzimin e atij objekti. Si kryetar i këshillit të fashit dhe si qytetar do të jetë përkrahës i

vazhdueshëm i kërkesave të këtyre banorëve, dhe konsideron se duhet të mbahet debati publik me këta qytetar dhe nëse ata vendosin që të vazhdohet ky projekt ai nuk e kundërshton. Në të kundërtën e kësaj ai përkrah idenë dhe kërkesën e banorëve të atjeshëm që objekti i vjetër i shkollës "Migjeni" të shfrytëzohet për bibliotekë, çerdhe dhe muze. Gjatë ditës së djeshme kryetari i komunës ka dal me një prononcim ku ka deklaruar në mënyrë të padrejtë se tre qytetar nga Stanoci i Epërm që i ka përmendur me emër nderta Berat Haradinaj polic i njësisë speciale që është vëlla im, dhe ai e ka nënshkruar vetë peticionin dhe ai ka bërë kallëzim penal ndaj kryetarit të komunës për shpifje. Faik Pronaj e ka nënshkruar peticionin vetë në rrugë në prezencë të dhjetë personave dhe aty kishte qenë edhe vetë ai dhe këto kryetari i komunës i ka keqpërdor këta emra dhe pretendimi se është shfrytëzuar peticion i banorëve të këtij fshati për pajisje me kontejner të mbeturinave edhe për këtë çështje është keqpërdorim i detyrës zyrtare dhe dokumentacionit zyrtar nga ana e kryetarit të komunës. Ky njeri është i prirur për dështim, ashtu siç ka dështuar lidhur me fabrikën e përpunimit të peshkut në Gracë, ashtu siç ka dështuar edhe në menaxhimin e fabrikës së "Llamkosit" në të njëjtën kohë ka dështuar edhe në këtë fabrikë të tekstilit pasi që po pretendohen 60 vende të punës, ndërsa më të shpallur konkursi del se aty do të punësohen 30 gra ndërsa 30 tjera do të janë praktikante. Andaj përfundimisht në dhjetë ditët e fundit janë terrorizuar nxënësit e shkollës, nga policia, mediat dhe protestuesit për këtë ka vetëm një përgjegjës ai është kryetari i komunës, ai është për debat publik dhe për zgjidhje të problemit duke marr në konsideratë interesin qytetar, por jo me nxitej, inate e keqpërdorime.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kjo situatë është vërtet sfiduese për gjithë anëtarët e kuvendit, dhe nuk i shërben askujt, që të shkaktohen dëme dhe konfrontim të banoret e atij fshati. Parimisht ai gjithherë ka qenë që objektet shkollore të shërbejnë vetëm për çështje edukativosimore. Po e vërteta është se është vetë LVV ka ndërtuar standarde, kur ishte çështja tek lokacioni i ndërtimit të depos për patatet, ku anëtaret e LVV-së mbronin kryetarin e komunës vetëm pse ishin në koalicion. Nga kjo del sheshazi fakti se nuk ka një konsistencë dhe qëndrueshmëri për ti shqyrtuar problemet në interes të qytetarëve dhe pa i politizuar ato. Pa dashur të polemizon me askënd, duhet shtruar, qartë dhe konkret se ky problem duhet zgjidhur, pa konsekuenca për askënd. Sipas ti ka gabime procedurale, sepse nuk është marr së paku miratimi nga këshilli i fshatit sikurse ishte më herët në fshatin Maxhunaj. Mirëpo tani gjendemi para një situate tjetër, ku është lidhur kontrata dhe janë shkaktuar pasojat juridike. Na anë tjetër kërkesa e banorëve të këtij fshati për të pasur çerdhe, muze, e kënd të leximit është plotësisht legitime dhe e drejt elementare e qytetarëve. Lidhur me këto dhe të tjera vlerëson se duhet dhënë përgjigje këtyre temave por në fryshtë e bashkëpunimit, dhe debatit të shtruar e korrekt të mirëbesimit me njëri tjetrin dhe duke përfillur interesat e qytetarëve të komunës sonë. Në këtë gjendje që ndodhemi është e vështirë që dikush të del kundër vendeve të reja të punës. Ai shtoi se duhet marr në konsideratë kërkesat e qytetarëve të atjeshëm që në planifikimin e buxhetit për vitin 2022 të futen edhe çerdha, muzeu dhe këndi i leximit, dhe kjo do të mund të rekomandohej por jo në objektin ekzistuese të shkollës, por si investim i ri. Andaj ai kërko përkrahje të këtij propozim ashtu që të dilet nga ky ngërç dhe të përkrahen kërkesat e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se pamjet që i kemi ndjekur këtyre ditëve në fshatin Stanoc i Epërm, vërtet kanë qenë të pakëndshme dhe kanë lënë një shije të hidhur. Por ajo se çfarë duhet pasur parasysh është që qytetaret atje dëshirojnë të kenë çerdhe, muze dhe bibliotekë dhe këto kërkesa duhet përfillur. Çelësi i problemit është se ka indikacione dhe dyshim për akuzë nga një anëtarë i kuvendit ndaj kryetari të komunës se ky i fundit ka përfitime monetare nga hapja e fabrikës në fjalë. Kryetari i komunës tenton që ta hapë këtë fabrikë sepse mendon që do ti përkthehet në vota, por tani ka konkurrencë nga anëtari i LVV-së dhe kryetari ka hyrë në minus sa

i përket këtyre votave. Qytetaret në fshatin Stanoc i Epërm vërtetë janë të manipuluar, ata nuk po dëshirojnë me punuar ata po dëshirojnë dije. Pastaj banoret atje kanë shqetësimet e tyre, për faktin se po rrezikohen fëmijët e tyre sepse ai objekt nuk ka dalje, ashtu që kur të rritet numri i veturave kësisoj rritet rreziku për nxënësit e shkollës. Për ta tejkaluar këtë situatë ai i sugjeron kryetarit të komunës që ti takoj ata banorë duke mbajtur një diskutim me ta duke i marr në konsideratë interesat e atyre banorëve.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit- të nderuar qytetar të Vushtrrisë, të nderuat bashkëvendës të Fshatit Stanovc i Epërm ,me lejoni të ju përvihendës të gjithëve duke dashur që gjithmonë të jam me ju dhe pranë jush ,në çdo gjendje dhe çdo situatë , edhe përkundër ditëve të vështira që kemi përjetuar bashkërisht , gjithmonë kam qenë zëri juaj dhe zëri i arsyes tuaj. Besoj që edhe tani në këtë kohë do të ju ndihmoj që ta tejkalojmë këtë situatë që është zhvilluar këto ditë rrëth çështjes së transferimit të ish objektit të shkollës së fshatit në një ndërmarrje punuese të –tekstili Meqenëse u krijuan disa mosmarrëveshje mes bashkëvendëseve tanë ,i ftoj të gjithë pa dallime partiake të kenë mirëkuptim dhe të na përkrahin hapjen e vendeve të reja të punës që të përmirësohen kushtet si ato sociale ekonomike dhe shoqërore në kohën më të vështirë e cila ka kapluar dhe ka rënduar tërë botën . Unë për veten time gjithmonë do ti përkrahi punët të cilat janë për të mirën e fshatit dhe Komunës në përgjithësi Andaj ju ftoj të gjithëve një zëri që ta përkrahim punësimin e 60 grave 60 familjeve të cilat do të na lehtësojnë dhe na ndihmojnë në stabilizimin e kushteve socio-ekonomike. Prandaj kërkoi që të gjendet një zgjidhje, për ta tejkaluar këtë gjendje, të pakëndshme duke shmanjur konfrontimin e banorëve lokal të fshatit Stanoc i Epërm. Pastaj vlerësoi se çështja e punësimit është imediate sidomos në konditat e pandemisë covid-19. Ai shtoi se duhet dhënë hapësirë që të hapen 60 vende të reja të punës, pasi është shumë e nevojshme të ndodh zhvillimi ekonomik. Ai doli në përkrahje të kërkesave të banorëve lokal të Stanocit të Epëm që të ndërtohet çerdhja, biblioteka dhe fusha sportive.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se pajtohet që të nxjerrët një rekomandim ku do të mundësohet vazhdimi i projektit, pastaj të projektohet në buxhetin e vitit 2022 hapja e çerdhes dhe këndit të leximit, ndërsa në buxhetin e vitit 2021 tani do ta ndërtojmë fushën sportive njësoj siç është ndërtuar tek shkolla “Mustafë Venhari” sepse kjo është e planifikuar në buxhet. Lidhur me çerdhen u zotu se do të dërgoj shkresë zyrtare në ministri e linjës që të lejohet stafi punues për çerdhen e fshatit Stanoc i Epërm. Tujte njoftoi se me UNICEFIN, komuna ka një marrëveshje për ti hapur pesë çerdhe në pesë fshatra të Komunës së Vushtrrisë, dhe këto çerdhe mendohet se do të hapen gjatë muajve të verë, ndërsa sa i përket çerdhes në fshatin Stanoc i Epëm në buxhetin e vitit 2022 do të planifikohen mjetet për ndërtimin e objekti të çerdhes, ndërsa stafi do të kërkohet të lejohet nga ana e ministrisë. Fakti se përsë është vendosur që ky investitor të investoj në fshatin Stanoc të Epëm nuk është për arsy elektorale, por për shkak të numrit të banorëve dhe për shkak të pozitës që ka ky fshatë. Ai apeloi tek të gjitha grupet kuvendare politike që ti japid hapësirë dhe mundësi këtij projekti që të punësohen 60 persona. Objekti i vjetër i shkollës i cili do të shërbej për këtë fabrikë punuese, nuk do të rrënohet përkundrazi ai do të rinovohet, dhe pas përfundimit të kontratës do të mund ti kthehet komuniteti dhe komunës. Vërtetësia e peticionit do të hetohet nga ana e organeve të rendit, pasi ka dyshime se ai është falsifikuar, në kohen kur janë kërkuar kontejnerët e mbeturinave. Nëse ai si kryetar i komunës ka interesa në hapjen e kësaj fabrike, atëherë ai e fton prokurorinë që të hetoj këtë rast dhe ai do të jap përgjegjësi. Ai ka pritur që grupi i grave delegate do të jetë më i zëshëm sepse po bëhet fjalë për punësimin e grave, kur dihet fakti se vetëm 17 % e grave në Kosovës janë të punësuara. Lidhur me debatin publik ai sqaroi se në javën e kaluar ai ka mbajtur një takim me banoret e këtij fshati nënshkruese të peticionit dhe para

tyre është zotuar se kërkesat e tyte për çerdhe, kënd leximi dhe për fushë sportive do të adresohen në buxhetin e komunës dhe të njëjtat do të implementohen.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-përsëriti dhe bëri thirrej kryetarit të komunës dhe anëtarëve të kuvendit që të kenë parasysh se gjendje atje në Stanoc të Epërm është tepër e ndjeshme, andaj mos të shkohet në situatën sa për ta marr një vendim, duke mos i llogaritur konsekuençat që do të pasojnë. Në këtë relacion nxënësit e asaj shkolle janë të terrorizuar.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se banoret na janë adresuar me anë të peticionit, dhe obligimi i kuvendit është që ta shqyrtoj peticionin ose ta aprovoj atë ose ta refuzoj. Dhe aprovimi konsiston në plotësimin e kërkesave për çerdhe, për kënd leximit dhe për fushë të sportit dhe atë ndërtim i ri në oborrin e shkollës, ose refuzohet sepse nuk ka pajtueshmëri.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-pyjeti anëtarin e kuvendit z. Ymer Haradinaj, se a është për realizmin e kërkesave të banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, që lidhen me ndërtimin e çerdhes, këndit të leximit dhe muzeut, apo është kundër realizimit të investimit për hapjen e fabrikës së tekstilit në atë objekt ku do të punësoheshin 60 persona. Nëse është pro kërkesave të këtyre banorëve për ndërtuar këto projekte të çerdhes dhe të tjera e atëherë është mirë që këto propozime të procedohen me tej të futen në buxhet ku të gjithë do ti përkrahim ashtu që të mos krijohet amulli. Por në të kundërtën nëse dikush për interesa politike dëshiron që të ndalet investitori, atëherë kjo është e papranueshme, sepse të gjitha bizneset kanë interesa por është edhe në interes të komunës të hapen 60 vende të reja të punës. Ai personalisht por edhe grupi kuvendar nuk do të mund të dilet kundër një biznesi që premton hapjen e 60 vendeve të reja të punës.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-vlerësoi se banoret e Stanocit të Epërm janë revoltuar për shkak se ata nuk janë përfillur, pse nuk janë njoftuar, pse nuk ka pasur debat me ta dhe krejt kjo e ka sjellë këtë situatë në të cilën gjendemi. Andaj ai insiston që të zhvillohet një debat publik me ata banor ashtu që të evitohet ndonjë situatë tjetër e pakëndshme dhe mos të sillen në pozitë të pa lakuueshme anëtarët e kuvendit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se kërkesa e peticionit të këtyre banorëve është e qartësuar e zeza në bardh, ku po kërkohet ndërprerja e kontratës e lidhur mes kryetarit të komunës dhe kompanisë së tekstilit "VITEX" në njërin anë dhe në anë tjetër kemi banor që e përkrahi këtë projekt për hapjen e asaj fabrike. Pastaj përsërit se kuvendit nuk ka të drejt të marr vendim për ndërprerjen e asaj kontrate sepse në këtë rast kryetari i komunës ka lidhur një kontratë duke u bazuar në rregulloren në fuqi, në të kundërtën nëse një kontratë e tillë anulohet komuna do të ketë pasoja juridike për fitimin e humbur të kompanisë. Ai tha se nuk është mirë të manipulohet me banorët përmes nënshkrimeve, dhe konsideron se personalisht nuk dëshiron të jetë në mesin e këtyre peticioneve. Lidhur me ndërtimin e çerdhes dhe muzeut vlerësoi se për këtë çështje vendos kuvendi i komunës, dhe atë në saj të buxhetit dhe adresimit të prioriteteve.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit-tha se është mirë që ky peticion fare mos të qitet në votim, kjo përfaktin se nëse njëri nga këto peticione është në prokurori duhet pritur verdikti i organeve të drejtësisë, edhe derisa këto organe të marrin një vendim, të pezullohen punimet në objektin e vjetër të shkollës "Migjeni" në fshatin Stanoc i Epërm.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se nga diskutimet e deritashme, shihet qartë se kryetari i komunës është i interesuar që të ketë problem në atë fshatë dhe jo të zgjidhen ato. Ai përsërit insistimin e tij se duhet të ndërpriten menjëherë punimet në atë objekt shkollor, dhe për këtë projekt duhet të pyeten banorët e atjeshëm përmes debatit qytetar apo përmes referendumit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-përsërit se është i gatshëm ti adresoj kërkesat e banorëve për ndërtimin të çerdhes, muzeut dhe këndit të leximit, por apeloi tek banoret e atjeshme që kenë maturi dhe qetësi, si dhe mos të dalin kundër punësimit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-sqaroi se nuk është kundër punësimit dhe hapjes së vendeve të reja të punës, por është kundër që bizneset të hapenë nëpër oborret e shkollave. Apeloj që para se të marrim një vendim të kemi kujdes sepse një vendim i dëmshëm do të shkaktoj pasoja të rënda për ata banor dhe përgjegjësin e bartim ne si kuvend.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, kërko dhjetë minuta pauzë për konsultim.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit- në rekapitullimin e debati lidhur me këtë çështje, adresoj propozimet e kuvendarëve si në vijim: në njëren anë propozimi për zhvillimin e debatit publik dhe për vendosje qytetare lidhur me atë fabrikë i mbështetur nga : Ali Januzi, Ymer Haradinaj dhe Lorik Maxhuni, ndërsa në anë tjetër është propozimi i mbështetur nga Xhafer Tahiri, Ilmi Azemi dhe Agim Bregaj që atje vazhdohet projekt i investimit në hapjen e fabrikës së tekstilit, dhe të adresohen dhe financohen kërkesat e banorëve për ndërtimin e çerdhes, këndit të leximit dhe fushës sportive.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kryesuesi i kuvendit hodhi në votim fillimisht propozimin që të mbahet debati publik për vendosje qytetare lidhur me investimin dhe hapjen e fabrikës së tekstilit , propozim i cili mori gjithsejtë **9 vota “për”** të tjerët nuk morën pjesë në votim. Propozimi tjetër që lidhet me vazhdimin e punimeve të projektit të investimit në hapjen e fabrikës së tekstilit, dhe të adresohen dhe financohen kërkesat e banorëve për ndërtimin e çerdhes, këndit të leximit dhe fushës sportive, mori **20 vota “për”** **1 votë “abstenim”**, të tjerët nuk morën pjesë në votim, andaj konstatojë se propozimi i dytë aprovohet.

Nga të cekurat më lartë u vendos me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 25 mars 2021, pas shqyrtimit të peticionit të banorëve të fshatit Stanoc i Epërm të parashtruar në emër të Ymer Haradinajt, anëtar i kuvendit, lidhur me kundërshtimin e marrëveshjes së lidhur mes kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z.Xhafer Tahiri dhe z.Xhelal Ismajlit, pronar i fabrikës së tekstilit “VITEX”, që ka të bëjë me kundërshtimin e shfrytëzimit të objektit të vjetër të Shkollës Fillore “Migjeni”, për qëllime biznesore, pas debateve dhe analizës së hollësishme të lartë shënuarve iu parashtron këtë:

REKOMANDIM

I Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë rekomandon që fabrika e tekstilit “VITEX” të vazhdojë aktivitetin biznesor në objektin e vjetër të shkollës fillore “Migjeni”, konform kontratës të lidhur me Komunën e Vushtrrisë.

II Qeveria Komunale, gjegjësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në planifikimin e buxhetit të komunës për vitin 2022, ti inkorporoj këto projekte: ndërtimin e çerdhes së fëmijëve, këndin për lexim dhe fushën sportive.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas debateve dhe analizave të hollësishme, e ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, ku ka vlerësuar se është imediate dhe tepër e nevojshme hapja e vendeve të reja të punës, andaj konsideron se biznesit të lartëcekur duhet ti jepet mundësia, që të filloj me investimin dhe realizimin e projektit për hapjen e asaj fabrike dhe vendeve të reja të punës. Andaj nga vlerësimet e bëra, kuvendi e hedhë poshtë peticionin e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm lidhur me kundërshtimin e marrëveshjes të lidhur mes kryetarit të Komunës së Vushtrrisë z.Xhafer Tahiri dhe z.Xhelal Ismajlit, pronar i fabrikës së tekstitit “VITEX”.

Kuvendi merr në konsideratë shqetësimet e banorëve të fshatit Stanoc i Epërm, dhe obligon qeverinë komunale që të realizoj projektet që lidhen me ndërtimin e çerdhes së fëmijëve, këndin për lexim dhe fushën sportive në fshatin Stanoc i Epërm.

14. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pyeti se KEDS, a është autoritet që i takon prona ti jepet pa kompensim, apo është dashur në këtë rast që kërkesa të vije nga ana e ministrisë së linjës, pasi që nuk kemi informacione se KEDS-i a ka marrëveshje me Republikën e Kosovës.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-sqaroi se kjo pikë e rendit të ditës është proceduar plotësisht në formë ligjore dhe kërkoj që të aprovohet, sipas praktikave që kemi pasur edhe më herët.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite e pronës se paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në ngastrën kadastrale Nr.P-028k-0, Zona Kadastrale Gojbullë e cila përfshin një sipërfaqe prej 25 m² të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5675m², pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Ngastra kadastrale e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë për 45 vite KEDS-it për vendosjen e Trafostacionit shpërndarës (Blindë) në sipërfaqe prej (4.4X2.2) m² pa kompensim.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Pjesë e këtij vendimi janë :certifikata për të drejtën e pronësisë, kopja e planit si dhe skica e prezantuar nga Kompania KEDS.

5. Ky vendim hyn ne fuqi 15 dite pas regjistrimit ne zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit ne faqen zyrtare të Komunës se Vushtrrisë.

15. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për specifikimin e projekteve kapitale të Komunës së Vushtrrisë;

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-sqaroi se tek pika 3 bujqësia, pika e 2 “Rregullimi i shtretërve të lumenjve ” në fshatrat Studime, Maxhunaj dhe Dumnicë e Mesme shuma financiare të korrigohet ku është specifikuar vlera prej 23,000.00€ duhet të jetë 60,000.00 €.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet specifikimi i projekteve kapitale sipas Udhëzimit administrativ 06/2019 për Kriteret Përgjedhëse të Projekteve Kapitale si në vijim:

1.1. Infrastruktura Publike(18184) projekti:

1.1.1.“Rindertimi i rrugëve me infrastrukturë ”, shuma.....100,000.00 €.

2. Bujqësi (47024):

2.1.“Ndërtimi i kanaleve kulluese në Lummadh dhe Dumnicë e Ulët” shuma 30,000.00 €;

2.1.1.“Rregullimi i shtratit të lumenjve në Studime, Maxhunaj dhe Dumnicë e Mesme” shuma.....60,000.00 €.

3. Shërbimet e Shëndetësisë Primare:

3.1.“Vendosja e rrethojave në QKMF Vushtrri” shuma.....30,000.00 €.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjetër kompetente komunale.

5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetën (15) ditë pas protokollimi në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

16. Diskutimi dhe shqyrtimi i gjendjes së Klubit të Futbollit “Vushtrria”;

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se e ka propozuar që të diskutohet kjo temë, pas shumë kërkësave të tifozëve të klubit dhe komunitetit sportiv. Tjtë ai vlerësoi se klub i futbollit “Vushtrria” ka pasur një reiting ashtu që më shumë i ka dhënë futbollistë Kombëtares Shqiptare se sa vetë klub i Tiranës. Ajo që është evidente është fakti se janë bërë disa investime modeste në stadiumin e klubit, si në fushë ashtu edhe në tribuna të cilat janë për tu përvendetur e ti cilat duhet të vazhdojnë. Aktualisht klub ndodhet në krizën më të madhe që nga themelimi i tij, ku lojtaret janë në bojkot, për shkak se me muaj të tërë nuk i kanë marr pagat e tyre, ashtu edhe punëtoret teknik. Për herë të parë në historinë njëqind vjeçare të klubit, janë mbyll dyert e stadiumit, këtë gjendje e ka sjellë kryetari i komunës Xhafer Tahiri, pasi ai është përgjegjës që në krye të klubit

është një individ si Bajrush Kajtazi, i cili si kryetar i klubit asnjëherë nuk e hap telefonin për të iu përgjigjur kërkesave të klubit dhe lojtarëve. Sjellja e këtij njeriu në kryer të klubit, është bërë nga ana e kryetarit të komunës, dhe kjo është bërë me qëllim për shkak të përfitimeve të dyanshme të tyre, andaj kjo është për keqardhje se është dashur të fitonte klubin "Vushtrria" dhe Vushtrria në përgjithësi. Sjellja arrogante e kryetarit të klubit Bajrush Kajtazi, ndaj tifozëve "Forca" ndaj stafit lojtarëve dhe komuniteti sportiv është e paprecend dhe e papranueshme. Ai kërkoi nga kryetari i komunës, që ai të negocioi me z.Bajrush Kajtazin, dhe ta lutë atë miqësish që të largohet nga klubin, pasi ai nuk është njeriu i duhur për ta menaxhuar klubin. Si kuvend i komunës, mund të adresojmë një zgjidhje, për mbulimin e disa prej obligimeve sici janë ato ndaj stafit, duhet të diskutohet me futbollistet dhe me stafin që ndoshta të gjithat nuk do të mund ti mbulojmë. Por që të krijohen rrethana dhe kushte që ai njëri të largohet nga klubin. Kësisoj do të përfundonte edhe bojkoti i lojtarëve ndaj klubit, ashtu që në tri ndeshjet vendimtare për të mbetur në ligën e dytë ti motivojmë lojtarët që ato ti fitojmë. Kjo do të mundësonë një qasje të re për investime të reja ashtu që klubin të rikthehet aty ku e ka vendin në super ligen e Kosovës. Ai kërkoi angazhim nga kryetari i komunës dhe drejtoresha e DKRS-së, që të angazhohen intensivishtë për ta gjetur një zgjidhje, për faktin se është vetë ky kryetar që ka shkaktuar këto problem, duke sjellë këtë njeri në krye të klubit

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se vetë pozicionimi i klubit të futbollit "Kosova" me traditë njëqind vjeçare, nuk është në nivelin ku e kemi pritur. Ndryshimet statusore të pozitës së klubit, kanë ndodhur në kuvendin e aksionerëve, edhe kjo nuk dihet se ata kanë pasur kompetenca për sa i takon kësaj çështje. Kompetencat e komunës janë tejet të limituara apo nuk ekzistojnë fare sa i përket ndërhyrjes në klub, sepse klubti ka qenë OJQ, por komuna i ka dal në ndihmë financiare këtij klubti ndoshta edhe jo në formën e plotë ligjore. Andaj i inkurajoj të gjithë që të angazhohen për gjetjen e një modaliteti në kuptim që klubti të ringitet dhe të ketë vendin e merituar.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-njoftoi se edhe më herët kishte deklaruar, që klubi i futbollit nuk është privatizuar. Pastaj shtoi dhe sqaroi se formua se si pretendohet privatizimi, i klubit është e dyshimtë sepse nuk bëhet privatizimi duke votuar kuvendi. Në këto rrethana ndikimi i komunës nuk mund të bëhet pasi kemi të bëjmë me një OJQ, por komuna duhet ti merre përgjegjësit që i takojnë sa i përket menaxhimit të fushës së sportit (stadiumit të qytetit), kjo do të mund të bëhej përmes aprovimit të një rregulloreje.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit-pyeti rrëth pozitës së klubit se a është OJQ, apo është privatizuar ky klub. Kryetari ose drejtoresha, është mirë të na jadin sqarime se çfarë statusi juridik, ka ky klub aktualisht, kjo edhe për faktin se që nga paralufta asnjëherë ky klub nuk ka qenë në pozitë më të vështirë, edhe sa i përket rangimit në tabelë edhe në kualitet. Si sugjerim i tij ishte të formohet një komision nga ekzekutivi dhe kuvendi, që do të angazhoheshin në bisedime me pronarin e klubit për të gjetur një zgjidhje për të dal nga kjo situatë.

Arta Ismajli, drejtoreshë e DKRS-së-tha se që kur ka marr detyrën si drejtoreshë është angazhuar bashkë me kryetarin e komunës, për të gjetur një zgjidhje sa i përket klubit. Pastaj sqaroi se nuk ka informata lidhur me statusin juridike të klubit se a ka të bëj me OJQ, ndonëse ka pasur një kuvend me pretendimin për privatizimin e klubit. Ka indikacione se në federatë është bërë regjistrimi i klubit si biznes, por nuk ka mundur të marr vërtet nga ATK-ja për shkak të obligimeve financiare që ka klubi. Pas konsultave që ka pasur me kapitenin e ekipit i cili kishte qenë shumë i revoltuar, bashkë me kryetarin e komunës i kanë bindur që ata të marrin pjesë në zhvillimin e aktiviteteve sportive. Kryetari i komunës ju kishte sugjeruar, që të mbajnë prapë kuvendin të shndërrojnë në OJQ klubin dhe kështu komuna do të kishte të drejtë ti subvencionoj por jo edhe si biznes. Kompetencat e komunës për të ndërhyrë në klub nuk ekzistojë, ndërsa gatishmëria e

komunës për ta ndihmuar klubin gjithherë ka ekzistuar dhe do të ekzistoj. Ajo u zotua se në bashkëpunim me kryetarin e komunës do të angazhohet në gjetjen e një zgjidhje për të dal nga kjo situatë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-njoftoi kuvendin për subvencionimin e sportit në përgjithësi dhe futbollit në veçanti për këto tri vitet e fundit, në vitin 2018 klubit të futbollit i janë ndarë 20,000.00 € shuma më e madhe që ka përfituar në histori nga komuna. Por megjithëkëtë kostoja e garës në super ligë ka qenë 300,000.00 €, këtë e dinë më së mirë donatoret që kanë qenë më herët dhe që tani janë asamblistë. Edhe për kundër faktit se i janë ndarë 20,000.00 € klubit, komuna ka marr vërejtje nga auditori i përgjithshëm për shkak se klubit ka pasur borxhe ndaj ATK-së, dhe subvencionimin e ndalon rregullorja. Pastaj është investuar në rregullimin e zhveshiores, që është bërë moderne me ngrohej qendrore me ujë të nxeh të dhe me gjithçka tjetër. Është rregulluar fusha ndihmëse brenda në stadium, janë rregulluar fushat ndihmëse në Doberllukë, dhe ajo që është më interesante dhe e rëndësishme, është futja në buxhetin e Ministrisë së Kulturës për vitin 2021 financimi i ndërtimit të stadiumit të qytetit sipas kategorisë së UEFA-së. Lidhur me politizimin e sportit, sqaroi se asnjëherë në jetën e tij nuk është përzierë në sport për ti dhënë konotacion politik. Në rrethanat aktual nuk ka të drejt komuna që kërkoj sqarime nga Federata e Futbollit, lidhur me statusin juridike të klubit, pasi do të konsiderohej ndërhyrje politike, dhe klubit do të mund të përjashtohej nga garat. Ligjërisht komuna nuk mund të interferojë në klub, sepse ka pasur vërejtje nga auditorit, dhe nëse ky raport i subvencioneve prej 20,000.00 € do të shkonte në prokurori dikush nga zyrtaret komunal do të mund të shkonte në përgjegjësi. Kryetari të ri të klubit iu është bërë me dije se kjo sitat në të cilën ndodhet klubit është e paqëndrueshme. Pastaj ai sqaroi se nuk ka sjell askënd në klub, por e ka ndihmuar klubin në momentet kur ka mbetur pa sponsor.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-përsëriti se kryetari i komunës ka ndikuar në vendosjen e kryetarit të klubit Bajrush Kajtazi dhe shtoi se historia e këtij klubit na takon të gjithëve edhe sukseset edhe dështimet. Klubi "Vushtrria" është bërë kampion edhe pa fusha ndihmëse, sepse dashuria për klubin dhe futbollin ka qenë e madhe edhe pse është luajtur pa kushte në lloç. Historia gjithherë përsërit në atë klub se e edhe në të kaluarën lojtaret kanë luajtur pa paga ata prapë luajnë, por duhet hequr kryerin e klubit nga ajo pozitë sepse ai është pengës për klubin dhe prosperimin e tij. Ai kërkoi nga strukturat komunale të angazhohen sinqerisht për të gjetur një zgjidhje për klubin ashtu që mos të ngecim në zhvillimin e aktiviteteve sportive por edhe rënien në ranglistat tabelore. **Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-duke ju referuar një shkrimi të ish-kryetarit të klubit "Vushtrria" i cili kishte deklaruar se po jep dorëheqje sepse politika i futi duart në sport ai është z.Naser Imeri, i cili njëherit është sponsor i madh i klubit "Vushtrria", i cili e ka avancuar pozitën e klubit nga liga e parë e ka sjellë Vushtrrinë në super ligë. Në rrethanat aktuale klubit gjendet në një pozitë jashtëzakonisht të vështir me trendin që të bie edhe nga liga e parë. Kërkoi nga kryetari dhe sportdashësit të angazhohen për tejkalimin e kësaj situate.

Arta Ismajli, drejtoreshë e DKRS-së-vlerësoi se ajo që e bënë të lumtur është fakti se kur bëhet fjalë për sportin të gjithë zhvishemi nga petku i politikës. Ajo edhe një herë përsërit dhe u zotua se në bashkëpunim me kryetarin e komunës por edhe me sportdashësit do të angazhohet në gjetjen e një zgjidhje më të mirë të mundshme.

17. Shqyrtimi i kërkesës së Fitim-Fazli-Pllanës për gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për zhvillimin e veprimitarisë së tij biznesore;

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-tha se personazh i kërkesës së saj është Fitim-Fazli-Pllana, i cili është një i papunë e i cili mundohet të punojë. Ky person të gjithëve na kujtohet sepse

ai shet fruta pranë rrugës në fshatin Nadakoc, a ka dekluaruar se ka filluar të punojë këtë punë përfaktin se nuk ka pasur ku të punojë dhe si ta mbajt familjen. Kërkesa e tij është që të ketë një objekt montazh një pikë ku do të mund të shiste frutat e tij, a njofton se ka parashtruar kërkesë disa herë në komunë dhe se komuna është e njoftuar me kërkesën e tij. Problemi qëndron se ai duhet dy apo tri herë në ditë të bartë frutat e tij prej shtëpisë deri tek pika shitëse dhe anasjelltas, ku ka një rrugëtim prej 10 km vetëm në një drejtim, kjo e bënë të lodhshme këtë punë dhe shpenzon shumë kohë. Ajo insiston se komuna mundet ti dal në ndihmë këtij personi, duke i ofruar një objekt montazh dhe kështu do të ndihmohet jo vetëm Fitim Pllana, por edhe familja e tij e cila ka dhënë shumë për Kosovën.

Gresa Muli, anëtar e kuvendit-pasi e përgëzoi parafolësen e saj për iniciativën, lidhur me kërkesën e Fitim/Fazli/Pllanën, shtoi se ajo personalisht nuk e njeh këtë person, por që ky njeri me punë e tij të ndershme aq shumë ka krijuar respekt, sa që ajo e ka bërë një shkrim për të Tuiter. Sa herë që kalon andej kur ai nuk ka konsumator Fitimin e sheh duke lexuar dhe nga ai ka marr dhuratë tre tituj të librave. Andaj kërkoi nga ana e qeverisë komunale që Fitimit të bëhet një zgjidhje duke iu caktuar një lokacion adekuat për zhvillimin e veprimtarisë së tij.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-njoftoi se Fitim Pllanen e ka mik të shtëpisë, dhe kërkoi nga parafolëset që të tregojnë formën se si mund ti ndihmohet në realizmin e kësaj kërkesë. Andaj ceku se të gjithë jemi për ti ndihmuar Fitimit, por vetëm se duhet të gjendet forma ligjore.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se duhet pasur kujdes që mos të krijojmë precedent, sepse kërkesa sikur se të Fitimit, kemi shumë. Pastaj njoftoi se komuna ka bërë thirrje publike që ti jap në shfrytëzim këto kjosjet nga druri që ndodhen afër objektit të komunës, dhe këtë do mund ta merret parashtruesi i kërkesë përmes aplikimit. Nëse nuk ka aplikuar atëherë mund të përsërit edhe njëherë shpallja publik ashtu që të respektohen procedurat ligjore. Tutej ai njoftoi për një rast nga një shkrim adresuar ndaj, ku një djalë nga Stanoci i Epëm kërkon që nëna e tij të adresohet për punë në fabrikën e tekstilit, pasi ajo është e vetme dhe ka tre fëmijë duke i shkolluar. Lidhur me këtë ai vlerëson se kemi mjaft shumë familje që kanë nevojë për punë dhe ndihmë por që fatkeqësisht komuna nuk ka mundësi që ti iu dal në ndihmë të gjithave.

Melihate Basholli-Latifi, anëtar e kuvendit-tha se asnjëherë nuk ka kërkuar diçka që bie ndesh me ligjin, por nga vullneti i mirë dhe me qëllim të gjetjes së një zgjidhje për këtë peron, ka marrë këtë iniciativë, edhe pse ai nuk e kishte porositur që iniciononte kërkesë.


Mbledhja përfundoi në ora 18:15.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

